

1 E hënë, 18 nëntor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,

6 Sekretare, paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar

8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i

9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep

10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,

12 të gjithëve. Për procesverbal, të akuzuarit janë të gjithë të

13 pranishëm në sallën e gjyqit sot.

14 Përpara sesa të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të

15 Prokurorisë 04679, ka tre çështje paraprake të cilat Trupi

16 Gjykues dëshiron që t'i trajtojë.

17 Së pari, Trupi Gjykues vëren që më 11 nëntor 2014, në

18 parashtrimin e protokolluar F02706, Trupat e Mbrojtjes

19 bashkërisht kërkuan leje për të apeluar urdhrin gojor të tretë

20 të Trupit Gjykues të datës 31 tetor 2024, që është një urdhër

21 gojor i pranuar si në provën V0008.

22 Në pajtim me rregullën 77(1):

23 "Ku një palë kërkon që një vendim i Trupit Gjykues për të

24 cilën Apeli nuk jep të drejtë, nuk parashikohet e drejta për

25 Apelim sipas ligjit dhe rregullave, që Pala të kërkojë

1 vërtetim dhe sqarimin e Trupit Gjykses që sa i takon vendimit  
2 në fjalë.”

3 Për më tepër në pajtim me rregullin 9(3):

4 “Afatet kohore të cilat janë përcaktuar për këtë urdhër  
5 gojor, për këtë vendim, për këtë gjykim janë dhënë.”

6 Atëherë përpara sesa i takon -- përpara se të japim një  
7 urdhër gojor lidhur me këtë kërkesë të përbashkët të Ekipeve  
8 të Mbrojtjes, dëshirojmë që të dëgjojmë palët se pse ata  
9 dëshirojnë që ky parashtrim duhet të konsiderohet sikur është  
10 dorëzuar përtej afateve.

11 Së pari, të dëgjojmë Palët.

12 Mbrojta e Viktimave.

13 Z. LAWS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne nuk kemi  
14 asnjë qëndrim sa i takon vonesave.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Tani të kalojmë tek parashtrimet për Prokurorinë.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar, të  
18 nderuar Gjykatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja.

20 Kush do që ta marrë fjalën prej jush?

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju jemi  
22 mirënjohës që na dhatë fjalën. Do ftonim Trupin Gjykses, që të  
23 lexojnë atë çfarë parashikohet në rregullore. Sa i takon  
24 cenimit për ne, për palët e përfshira, ne mendojmë që vonesa e  
25 shkurtër ka shkaktuar cenim të ekipeve të Mbrojtjes. Dhe në

1 këto rrethana, ne mendojmë që kërkesa nuk duhet të pranohet  
2 sepse është bërë përtej afateve.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
4 Ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

5 Trupi Gjykses ka dëgjuar parashtrimet e palëve dhe  
6 pjesëmarrësve dhe do të nxjerrë një urdhër sa i takon  
7 parashtrimin F02726 në kohën e duhur.

8 Së dyti, Trupi Gjykses vëren që paketa e nxjerrjes 1413  
9 dhe 1477, ZPS-ja ka nxjerrë versione të dy dokumenteve të  
10 cilat përkatësisht janë pranuar si provë gjyqësore P0085-ET  
11 dhe P00181-ET. Të premtën ZPS-ja qarkulloi një email ku  
12 kërkonte që versionet e rishikuara të zëvendësonin provat e  
13 pranuar gjyqësore P00895-ET dhe P00181-ET.

14 A ka ndonjë kundërshtim nga Ekipet e Mbrojtjes lidhur me  
15 këtë? Duket sikur nuk ka kundërshtime na palët.

16 Atëherë dokumenti U002-0163 deri në U002-0208-ET  
17 Rishikuar 1 do të zëvendësojë versionin që ka qenë i pranuar i  
18 si prova P00895-ET. Dhe dokumenti SPOE00226662 deri në  
19 SPOE00226674-ET E Rishikuar do të zëvendësojë provën e pranuar  
20 deri tani si P00181-ET.

21 Kjo përfundon urdhrin me gojë.

22 Pra, ky ishte urdhri gojor lidhur me këtë aspekt.

23 Më 15 dhjetor 2024, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë që kishte  
24 të bënte me rendin e provave. Ka të bëjë me parashtrimin  
25 F02727.

1 Të njëjtën ditë, Trupi Gjykses njoftoi palët dhe  
2 pjesëmarrësit që do të marrë parashtrimet në përgjigje dhe do  
3 të marrë një vendim gojor sot.

4 Mbrojta e Viktimave, a keni ndonjë përgjigje lidhur me  
5 këtë çështje?

6 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ekipet e  
8 Mbrojtjes, a keni diçka për të parashtruar.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne e kundërshtojmë mocionin.  
10 Qëndrimi ynë është se ka vlerë që Avokati i Caktuar kryesisht,  
11 ose Avokati Mbrojtës do të ketë mundësi që të shohë dokumentet  
12 në mënyrë të tillë që të jetë i përgatitur siç duhet dhe t'i  
13 japë këshillat e nevojshme klientit të vet. Kështu që për këtë  
14 arsye ne mendojmë që ka efikasitet dhe ka vlerë në mënyrë të  
15 tillë që Avokati të mund të shohë dokumentet dhe të shohë  
16 cilat janë dokumentet në listën e dokumenteve të palës  
17 përkatëse.

18 Sa i takon masave të sigurisë, më lejoni të theksoj që  
19 Avokati Kujdestar ka detyrë që të respektojë detyrimet etike  
20 sikurse kemi dhe ne të drejtën për detyrimet etike, kështu që  
21 për këtë arsye nuk ka asnjë problem.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
23 Ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

24 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Edhe ne pajtohemi ma atë çfarë  
25 tha z. Misetiç. Dhe ky është dëshmitar i Prokurorisë dhe si

1 rezultat në momentin kur dëshmitari ka një avokat kujdestar,  
2 atëherë avokati kujdestar duhet që të ketë qasje në të gjitha  
3 dokumentet dhe nuk duhet që të mos lejohet që të ketë qasje në  
4 dokumente. Ne mendojmë që kjo i shërben procesit të rregullt  
5 gjyqësor dhe për këtë arsye mendojmë që nuk duhet që të mos i  
6 jepen dokumentet personit në fjalë.

7 Z. TULLY: [Përkthim] Edhe ne e mbështesim atë që thanë  
8 kolegët. Nuk e kemi asgjë tjetër për të shtuar.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe i mbështesim parashtrimet e  
10 kolegëve.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses  
12 do të japë urdhër lidhur me këtë kur të vijë momenti.

13 ZPS-ja në qoftë se keni ndonjë gjë për të  
14 kundërpërgjigjur?

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, thjesht  
16 shkurtimisht kërkesa ishte që ne do ta lejojmë Avokatin  
17 Kujdestar që të shikojë dokumentet në momentin kur ta shikojnë  
18 të gjithë palët e tjera.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

20 Dhe sikurse e thashë dhe më përpara, Trupi Gjykses do të  
21 marrë një vendim kur të jetë e përshtatshme.

22 Ka ndonjë pyetje për të bërë nga personat, nga Gjykatësit  
23 e tjerë?

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndoshta për ZPS-në. A mund  
25 të na thotë ZPS-ja se çfarë qëndrimi keni ju lidhur me

1   parashtrimet e z. Misetic që avokati duhet të ketë mundësinë  
2   që të japë këshilla të kuptimta, kuptimplote për klientin dhe  
3   duhet që të ketë dokumentet paraprakisht? Çfarë qëndrimi keni  
4   ju lidhur me këtë?

5           ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dokumentet  
6   në vetvete nuk reflektojnë domosdoshmëri ndonjë pozicion  
7   fajësues. Ka të bëjë me faktin që ai do bëhet -- atij do t'i  
8   bëhen pyetje në Gjykatë lidhur me këtë dokument, kështu që sa  
9   i takon pyetjet që ne do të bëjmë, ne do të kemi një kontekst  
10  konkret të pyetjeve dhe si rezultat do jetë e nevojshme që të  
11  shikohen këto dokumente.

12           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon dhe  
13  ju kam përshtypjen që doni të thoni diçka lidhur me një aspekt  
14  që ka të bëjë me këtë dëshmitar, apo jo?

15           Z. DIXON: [Përkthim] Po. Faleminderit.

16           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa për të  
17  thënë që e kemi lexuar emailin që në keni dërguar.

18           Z. DIXON: [Përkthim] Ashtu siç e kam dhe shkruar,  
19  megjithatë nuk është se do futem në hollësi lidhur me emailin.

20           Megjithatë, më lejoni të them që kërkesa është bërë  
21  përpara pyetjes kryesisht të dëshmitarit nga Prokuroria dhe  
22  nuk duam që të pengojmë fillimin e procesit gjyqësor sot,  
23  megjithatë dua të them që kemi pasur njoftim me vonesë, pra,  
24  ne kemi marrë njoftimin të shtunën në mëngjes, pra, në  
25  fundjavë dhe ndërkohë shënimin përgatitor ne e kemi marrë

1 vetëm në mbrëmjen e së premtes. Sigurisht, nuk do të ishte  
2 problem në qoftë se dëshmitari do kishte ardhur më vonë gjatë  
3 javës sepse do të na jepte kohë neve që të përgatiteshim siç  
4 duhet dhe të merrnim parasysh informacionin e dhënë në  
5 shënimet përgatitore dhe për të marrë udhëzime nga klienti.

6 Ne po e kërkojmë këtë për shkak të momentin të fundit ose  
7 vonesës sa i takon ndryshimit që ka ndodhur kur nuk jepen  
8 arsye. Dhe për këtë arsye, ne do kemi vetëm deri nesër në  
9 mëngjes në mënyrë të tillë, pra, kemi kohë deri nesër në  
10 mëngjes në mënyrë të tillë që të mund të vazhdojmë me pyetjet  
11 prej nesh të dëshmitarit.

12 Pasi jemi konsultuar edhe me ekipet e tjera kjo nuk do të  
13 ndihmonte shumë. Kështu që mendojmë që do ishte më mirë që  
14 dëshmitari tjetër të fillonte dhe të përfundonte, pra, marrjen  
15 në pyetje nga Prokuroria dhe pyetjet prej nesh mbështetur në  
16 vlerësimet e kohës që kemi bërë paraprakisht.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në mënyrë që  
18 të mos humbim kohë, a ka ndonjë arsye që pse Ekipet e tjera të  
19 Mbrojtjes nuk e bëjnë marrjen në pyetje së pari dhe pastaj,  
20 domethënë, së pari të fillojnë Ekipet e tjera të Mbrojtjes të  
21 bëjnë pyetje dhe në fund fare të bëni ju pyetje?

22 Z. DIXON: [Përkthim] Ky është një dëshmitar që ka të bëjë  
23 kryesisht me klientin tim dhe pyetjet kryesore do bëj unë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndoshta do  
25 ishte më mirë që të bëjnë pyetjet Ekipet e tjera të Mbrojtjes

1 fillimisht dhe pastaj juve të mund të vazhdoni me pyetjet  
2 tuaj. Sepse nuk duam që të humbim një ditë të tërë lidhur me  
3 këtë.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk dua ta bëj as unë këtë gjë. Nuk  
5 dua të humb as unë kohë. Megjithatë vendimi është marrë në  
6 momentin e fundit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk dua që të  
8 futem te diskutimi i përgatitjes prej jush, megjithatë ky  
9 është një person i cili pritet që të fillojë dëshminë e vet  
10 nesër. Po thoni që nuk jeni përgatitur akoma?

11 Z. DIXON: [Përkthim] Jo, jo, sigurisht, që jemi  
12 përgatitur.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po atëherë  
14 duhet të jeni gati për të filluar.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Duke marrë parasysh këtë  
16 informacionin që kemi pasur përpara, ne mendojmë që dëshmitari  
17 do të marrë më shumë kohë seç kishim menduar. Dhe nuk është po  
18 kërkojmë ditë të tëra. Pra, po flasim për një shtyrje të  
19 shkurtër. Ndoshta një orë ose dy orë. Dhe duhet ta pranoni  
20 faktin që Prokuroria pa dhënë asnjë arsye ka bërë ndryshime  
21 momentet e fundit, na ka dhënë informacion momentet e fundit,  
22 të nderuar Gjykatës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne besojmë që  
24 palët të na japin një pyetje të ndershme ose deklaratë të  
25 ndershme. Kështu që nuk kemi dyshime që Prokuroria ka arsyet e



1 veta që rendi i dëshmitarëve të jetë ai që ka kërkuar  
2 Prokuroria. Nuk po vë në dyshim as atë çfarë po më thoni ju  
3 mua sot. Megjithatë, atë çfarë po them është që nuk jemi më në  
4 pozitë që të humbim kohë dhe në qoftë se do ta bëjmë këtë gjë,  
5 i takon që do humbasim kohë.

6 Do fillojmë me pyetjet e drejtpërdrejta të Prokurorisë.  
7 Më pas, në pushimin e radhës, do bëjmë një vendim se çfarë do  
8 të ndodhë më tej.

9 Prokuroria ka ndonjë gjë për të thënë?

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shkurtimisht  
11 dua t'ju them që ndryshimi në rendin e dëshmitarëve të ZPS-së  
12 ishte përtej kontrollit të ZPS-së, për procesverbal dua të  
13 them që shënimet përgatitore janë dorëzuar në përputhje me  
14 paragrafin 96 të Urdhrit për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

16 Z. TULLY: [Përkthim] I nderuar Gjykatës --

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

18 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kam ndonjë gjë për të thënë  
19 lidhur me këtë dëshmitar, megjithatë kam diçka lidhur me  
20 dëshmitarin e javës që vjen. Nuk më kujtohet tamam numri por  
21 besoj që do jetë dëshmitari që do japë dëshmi të hënën.

22 Dëshmitari është në një pozicion ku ai do të ushtrojë të  
23 drejtat e veta për të mos folur për pjesën më të madhe të  
24 informacionit që parashikohet që të mbulohet nga Prokuroria.  
25 Na është thënë që katër orë do të nevojiten në mënyrë që të

1 bëhen pyetjet e drejtpërdrejta. Ndërkohë që kemi marrë  
2 dokumente të cilat janë shtuar tek dokumentet fillimisht të  
3 planifikuara për këtë dëshmitar që nuk kanë asgjë të bëjnë me  
4 informacionin e mëparshëm. Kështu që, ne na duhet që të marrim  
5 shënime përgatitore sa i takon kohës sesa i duhet Prokurorisë  
6 për të marrë në pyetje këtë dëshmitar në pajtim me Urdhrin për  
7 Zhvillimin e Procesit Gjyqësor.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigje nga  
9 Prokuroria?

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

12 Mund të vazhdoni, z. Ellis.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, së pari, dua që  
14 të vërej mbështetjen, dua që të mbështes atë çfarë tha kolegu  
15 im sa i takon pozicionit të Prokurorisë dhe sa i takon edhe  
16 Mbrojtjes së z. Veseli në parim lidhur me këtë dëshmitar.

17 Dhe, së dyti, do doja të them që më duhet më pak kohë  
18 sesa kisha thënë paraprakisht.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa më pak  
20 kohë?

21 Z. ELLIS: [Përkthim] 15 minuta ose më pak se kaq.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Unë nuk pres që të kem ndonjë  
24 pyetje, megjithatë do ta rivlerësoj përsëri.

25 Z. TULLY: [Përkthim] Edhe ne, të nderuar Gjykatës, nuk

1 kemi pyetje për momentin për dëshmitarin.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Znj. Asistente, ju lutem, silleni dëshmitarin në sallë.

4 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
8 jemi në seancë të hapur. Konfirmoj që masat mbrojtëse janë  
9 hequr dhe duke filluar që tani dëshmitari do japë dëshmi pa  
10 shtrembërim zëri dhe fytyre.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
12 znj. Sekretare.

13 A e kuptoni këtë, Dëshmitar?

14 DËSHMITARI: Po.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistentja --  
16 ju lutem ngrihuni në këmbë.

17 Asistentja do t'ju japë tekstin e betimit solemn të cilin  
18 ju duhet ta lexoni në pajtim me rregullin 141(2) i Rregullores.  
19 Ju lutem hidhini një sy dokumentit pastaj lexojeni me zë atë.

20 DËSHMITARI: Po.

21 I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe  
22 përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do ta them  
23 të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk  
24 do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

25 DËSHMITARI: NEZIR ÇOÇAJ

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
2 Dëshmitar. Tani mund të uleni.

3 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që  
4 parashikohet që të zgjasë pak a shumë një ditë. Sikurse mund  
5 ta dini, Prokuroria do t'ju bëjë e para pyetjet. Më pas Ekipet  
6 e Mbrojtjes kanë të drejtë t'ju bëjnë pyetje, po ashtu edhe  
7 anëtarë të Trupit Gjykses mund t'ju bëjnë pyetje.

8 Prokuroria ka vlerësuar se i nevojitet një orë për  
9 pyetjet ndaj jush. Ekipet e Mbrojtjes kanë vlerësuar që i  
10 nevojiten afërsisht katër orë. Si në raste të tjera dhe lidhur  
11 me çdo vlerësim, ne shpresojmë që Ekipet e Mbrojtjes dhe Palët  
12 e tjera do të përdoren kohën në mënyrë efikase. Trupi Gjykses  
13 do të përdorë pyetje plotësuese në qoftë se do të përmbushen  
14 kriteret lidhur me këtë.

15 Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni pyetjeve me fjali të  
16 shkurtra dhe të qarta. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen,  
17 lirisht mund t'i kërkonti avokatit përkatës që ta sqarojë  
18 pyetjen më tej. Po ashtu, na thoni se cila është baza e  
19 njohurive, fakteve dhe rrethanave për të cilat do të pyeteni.

20 Në rast se ZPS-ja ju kërkon që të konstatooni disa  
21 korrigjime që ju keni bërë për një deklaratë ose deklaratat të  
22 tjera të mëhershme tuajat, ju duhet që të konfirmoni që  
23 deklaratat me shkrim, plus korrigjimet ose sqarimet tuaja,  
24 pasqyrojnë saktësisht dëshminë.

25 Ju lutem flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë prej

1 pesë sekondash përpara sesa të jepni përgjigje ndaj një  
2 pyetjeje dhe flisni qartë dhe ngadalë për hir të përkthyesve.

3 Gjatë ditëve që do të jepni dëshmi përpara Trupit Gjykses  
4 nuk lejohet që të diskutoni me askënd jashtë sallës së gjyqit  
5 lidhur me përmbajtjen e dëshmisë. Në qoftë se ndonjë person  
6 nga jashtë Gjykate vjen dhe ju bën pyetje lidhur me dëshminë  
7 tuaj, duhet të na e bëni me dije këtë gjë.

8 Ju lutem në qoftë se ju kërkohet që të mos flisni më duhet  
9 të ndërprisni së foluri ose në qoftë se më shikoni që kam  
10 ngritur dorën duhet po ashtu të ndërprisni së foluri. Sepse  
11 kjo do të thotë që duhet që t'ju japë disa udhëzime. Në qoftë  
12 se e ndjeni në nevojshme për të bërë pushime, na e thoni këtë  
13 gjë dhe ne do të bëjmë organizimet përkatëse.

14 Tani do të fillojmë me pyetjet nga Prokuroria. Prokuroria  
15 është ulur në të majtën tuaj. Ju lutem dëgjojeni me vëmendje.

16 Znj. Prokurore, është fjala për ju.

17 Pyetje nga znj. Iodice:

18 ZNJ. IODICE: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 PY. [Përkthim] Mirëmëngjes, Dëshmitar. Unë quhem Vega Iodice  
20 dhe sot do t'ju bëj pyetje në emër të ZPS-së. Sikurse jua kam  
21 shpjeguar edhe gjatë takimit të fundit, në vend që t'ju bëj  
22 pyetje për çdo lloj gjëje për të cilën ju keni informacion,  
23 është e mundur që deklaratat tuaja të pranohen drejtpërdrejt  
24 si prova gjyqësore. Në mënyrë që të bëhet kjo gjë duhet që të  
25 ndiqen disa hapa proceduralë.

1 Përpara sesa të kaloj tek hapat proceduralë, dua që t'ju  
2 pyes për emrin dhe mbiemrin. A mund të na thoni si quheni,  
3 Dëshmitar?

4 PË. Nezir Çoçaj.

5 PY. Kur keni lindur, datëlindja juaç cila është?

6 PË. 27 shtator 1970.

7 PY. Çfarë shtetësie keni?

8 PË. Jam shtetas i Kosovës.

9 PY. Çfarë niveli arsimor keni?

10 PË. Kam master shkencor në shkencat e edukimit.

11 PY. Dëshmitar, i keni dhënë në të shkuarën një dëshmi ZPS-së,  
12 keni pasur mundësi që këtë dëshmi të mund ta rishikonit gjatë  
13 seancës përgatitore. Sot do të kërkojmë që dëshmia juaç e  
14 mëhershme për ZPS-në të pranohet në prova gjyqësore.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për këtë do i kërkoj Sekretares  
16 që të paraqesë në ekran dokumentin 02169-TR-ET dhe përkthimin  
17 përkatës në shqip.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është  
19 dokumenti që përfundon me RED2?

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, përfundon me RED3.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
22 RED3.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Sa për sqarim është  
24 Pjesa 3, apo jo?

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, Pjesa 1.



1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Do  
2 paraqes Pjesën 1.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar, ndërkohë që do të paraqitet dokumenti në  
5 ekran, a ju kujtohet që ZPS-ja ju ka marrë në intervistë në  
6 vitin 2021?

7 PË. Po.

8 PY. A ju kujtohet ta keni lexuar këtë deklaratë në gjuhën  
9 tuaj përpara një jave?

10 PË. Po.

11 PY. A ju kujtohet që patët mundësi që të bënit korrigjime dhe  
12 sqarime në deklaratën e dhënë?

13 PË. Po.

14 PY. A ju kujtohet që korrigjimet janë shkruar në një shënim  
15 dhe më pas ju janë lexuar ju, ju kujtohet kjo?

16 PË. Po.

17 PY. A konfirmoni se informacioni që ju është lexuar mbrapsht  
18 në atë shënim, pasqyron saktësisht ndryshimet dhe korrigjimet  
19 e bëra prej jush?

20 PË. Po.

21 PY. Në qoftë se do të përfshijmë të gjitha korrigjimet dhe  
22 sqarimet që keni bërë përpara një jave, informacioni që keni  
23 dhënë ju në deklaratën tuaj a është saktë dhe i vërtetë me aq  
24 sa dini dhe besoni ju?

25 PË. Po.

1 PY. Në qoftë se do t'ju bënin të njëjta pyetje sot për të  
2 njëjtat ngjarje, a do të jepnit të njëjtat përgjigje,  
3 Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Pas përmbushjes së kriterëve të  
6 rregullës 154, në përputhje me vendimin e parashtruar -- me  
7 vendimin e protokolluar F02720, paragrafi 96, dëshirojmë të  
8 kërkojmë të pranohen në prova materiale dokumentet 091269-TR-  
9 ET Pjesa 1 RED3, Pjesa 2 RED2, Pjesa 3 RED2, Pjesa 4 RED3,  
10 Pjesa 5 RED3 dhe përkthimet përkatëse në shqip.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
12 kundërshtime?

13 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk  
16 ka kundërshtim, dokumenti 091269-TR-ET Pjesa 1 deri në Pjesën  
17 5, sikurse u caktuan nga Prokurorja, pranohen si prova  
18 gjyqësore.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
20 faleminderit. Pjesa e parë e deklaratës së dëshmitarit, në  
21 anglisht dhe në shqip, do të marrë numrin e provës P01834.1.  
22 Pjesa 2, në anglisht dhe në shqip, do të marrë numrin e provës  
23 P01834.2. Pjesa 3 do të marrë numrin e provës P01834.3. Pjesa  
24 4 do të marrë numrin e provës P01834.4. Dhe, pjesa e fundit,  
25 Pjesa 5 do të marrë numrin e provës P01834.5.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
2 znj. Sekretare.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani kërkojmë të pranohet dhe  
4 Shënimi Përgatitor numër 1 që mban numrin ERN 123591 deri në  
5 123603.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
7 kundërshtime?

8 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Meqenëse nuk  
10 ka kundërshtime, materiali me numër 123591-123603 pranohet.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimi Përgatitor  
12 numër 1 do të marrë numrin e provës P01835. Klasifikimi është  
13 konfidencial sikurse janë dhe të gjitha pjesët e deklaratës,  
14 pra, klasifikimi i të gjithave është konfidencial.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkojmë pranimin dhe të dy  
17 provave materiale shoqëruese, që mbajnë përkatësisht numrin  
18 091265-091268 dhe përkthimin në gjuhën angleze që ka numrin  
19 SITF00249032 deri në SITF00249032.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
21 kundërshtime për provat materiale shoqëruese?

22 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull  
24 atëherë. Dy provat materiale shoqëruese siç u renditën  
25 pranohen.

1           SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Prova e  
2 parë materiale shoqëruese me numër 091265-091268, në shqip dhe  
3 në anglisht, do të marrë numrin e provës P01836. Klasifikimi  
4 është konfidencial.

5           Dhe prova materiale shoqëruese e dyta pra, me numër  
6 SITF00249032 deri në SITF00249032, në shqip dhe në anglisht,  
7 do të marrë numrin e provës P01837. Dhe klasifikimi është  
8 konfidencial.

9           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
10          Mund të vazhdoni.

11          ZNJ. IODICE: [Mikrofoni çaktivizuar].

12          [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me lejen tuaj dua të  
13 lexoj një përmbledhje të shkurtër të këtij dëshmitari.

14          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Miratohet.

15          ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dëshmitari me numër 04679 është  
16 shqiptar i Kosovës që u kyç në UÇK në periudhën mars, prill  
17 1998. Gjatë kësaj periudhe me UÇK-në, ai ndihmoi për  
18 organizimin e UÇK-së në territorin e tij dhe më vonë u kyç në  
19 Zonën Operative të Pashtrikut.

20          Dëshmitari W04679 jep dëshmi lidhur me strukturën dhe  
21 organizimin e UÇK-së, përfshirë Zonën Operative të Pashtrikut,  
22 komunikimet që ka pasur me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm  
23 të UÇK-së dhe çfarë ka parë ai me sytë e tij dhe çfarë ka  
24 vërejtur në ish-ndërtesën e MUP-it në Prizren në qershor të  
25 1999.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, tani unë kam disa pyetje për ju. Fillimisht,  
4 të fokusohemi në vendndodhjen e UÇK-së në Prizren në qershor  
5 të 1999.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I lutem Sekretares së seancës të  
7 vendosë në ekran materialin 058255 dhe kjo mund t'i përcillet  
8 edhe publikut.

9 PY. Z. Çoçaj, a e njihni këtë ndërtesë?

10 PË. Po.

11 PY. Çfarë është?

12 PË. Kjo është ndërtesa e konvikteve në Prizren.

13 PY. Ne qershor të 1999 a keni shkuar ju tek ky vend?

14 PË. Po.

15 PY. Kush ishte i stacionuar aty?

16 PË. Ka qenë komanda e zonës së Pashtrikut.

17 PY. Faleminderit.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj  
19 pranimin e kësaj fotografie si pjesë e provave gjyqësore.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
21 kundërshtime?

22 Z. DIXON: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka  
24 atëherë kundërshtime.

25 Fotografia që mban numrin 058255 pranohet.

1           SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë  
2 numrin e provës P01838 dhe aktualisht në *Legal Workflow* ka  
3 klasifikimin konfidencial.

4           ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të jetë dokument publik.

5           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

6 Riklasifikojeni.

7           ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, të shkojmë në faqen që  
8 mban numrin 058257-058258 dhe më konkretisht në faqen 058258.

9 PY. Z. Çoçaj, a e njihni këtë ndërtesë?

10 PË. Po.

11 PY. Çfarë është kjo ndërtesë?

12 PË. Duhet të jetë e njëjta ndërtesë e konvikteve. Por siç po  
13 shihet tash është e rinovume.

14 PY. Faleminderit. A është e njëjta ndërtesë kjo sikurse  
15 ndërtesa që pamë më herët ku qëndronte komanda e Zonës  
16 Operative të Pashtrikut?

17 PË. Mendoj se po.

18 PY. Faleminderit.

19           ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj  
20 pranimin e kësaj faqeje si pjesë e provave gjyqësore.

21           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
22 kundërshtime?

23           PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

24           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka  
25 kundërshtime.

1 Materiali me numër 058257-058258 -- ju doni vetëm këtë  
2 faqe, apo jo?

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, vetëm këtë faqe.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë  
5 pranohet faqja që mban numrin 058258.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo faqe do të marrë  
7 numrin 01839. Klasifikimi është konfidencial.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 ZNJ. IODICE: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
11 Riklasifikojeni.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

14 PY. Z. Çoçaj, mesa keni ju dijeni, cilat ndërtesa të tjera,  
15 përveç kësaj, në Prizren ka përdorur UÇK-ja në qershor të 1999  
16 pas Marrëveshjes së Kumanovës?

17 PË. Pas kësaj ka qenë edhe Shtëpia e Armatës në Prizren dhe  
18 ka qenë shkolla, shkolla e shurdhë-memecëve në Prizren.

19 PY. A e dini ju cila njësi qëndronte në Shtëpinë e  
20 Armatimeve?

21 PË. Në Shtëpinë e Armatës nuk di saktësisht, një kohë ka qenë  
22 edhe ajo ka qenë, është përdorur, po nuk e di sa gjatë si  
23 komandë e zonës. Pastaj dhe kanë flejt disa ushtarë që nuk  
24 kanë pasur vendbanim në Prizren.

25 PY. Që të jemi të qartë për ndërtesën, Shtëpia e Armatës a

1 përdoret aktualisht për komunën, nga komuna?

2 PË. Po, përdoret.

3 PY. Ju përmendët dhe shkollën e shurdhë-memecëve. Po atje  
4 kush qëndronte?

5 PË. Ka qenë selia e Brigadës 125.

6 PY. Faleminderit. E njihni Samedin Xhezairin?

7 PË. Po.

8 PY. Mesa keni ju dijeni, a ka qenë anëtar i UÇK-së?

9 PË. Ka qenë.

10 PY. Faleminderit. I cilës brigadë?

11 PË. 125.

12 PY. A ka pasur ushtarë të UÇK-së në atë zonë të Prizrenit që  
13 quhej Tusuz, dini gjë?

14 PË. Nga ajo lagje me siguri ka pas ushtarë të UÇK-së.

15 PY. E keni fjalën qëndronin atje apo vinin prej asaj lagjeje?

16 Domethënë, në atë zonë, në Tusuz ka pas të pranishëm ushtarë  
17 të UÇK-së?

18 PË. Vinin nga ajo zonë. Duhet dhe të ketë pas. Nuk e di, po

19 vinin nga ajo zonë se pothuajse secila lagje e Kosovës ka pas

20 persona që kanë veshur uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të

21 Kosovës.

22 PY. Faleminderit.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dua të shohim një video, një

24 material filmik. Ju lutem të vendosim në ekran provën që mban

25 numrin 01193. Nuk kam nevojë për përkthim. E fillojmë videon,



1 ju lutem, që nga fillimi dhe ndalojmë në 00:02.

2 [Luhet videoincizimi]

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

4 PY. Z. Çoçaj, e njihni këtë ndërtesën në sfond?

5 PË. Po.

6 PY. Çfarë është?

7 PË. Në pjesën e djathtë është ndërtesa e Gjykatës së

8 Prizrenit.

9 PY. Po në të majtë?

10 PË. Kjo ka qenë ndërtesë ku janë lëshuar dokumentet e

11 identifikimit në kohën e regjimit serb.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Vazhdojmë dhe e ndalojmë videon

13 tek segmenti kohor 00:19.

14 [Luhet videoincizimi]

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

16 PY. Këtë personin a e keni parë ndonjëherë më përpara?

17 PË. Duhet ta kem parë.

18 PY. Mesa dini ju, a ka qenë ky anëtar i UÇK-së?

19 PË. Po.

20 PY. Domethënë, ka qenë, po, ka qenë?

21 PË. Po, ka qenë.

22 PY. I cilës zonë?

23 PË. I zonës së Pashtrikut.

24 PY. Je në gjendje të na thuash pjesë e cilës njësi ka qenë?

25 PË. Ka qenë pjesë e policisë ushtarake.

- 1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Vazhdojmë.
- 2 [Luhet videoincizimi]
- 3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ndalojmë këtu, ju lutem.
- 4 PY. Ndërtesën në sfond e njihni?
- 5 PË. Po.
- 6 PY. Çfarë është kjo ndërtesë?
- 7 PË. Ka qenë objekti i policisë serbe të regjimit.
- 8 PY. Domethënë, ish-ndërtesa e MUP-it?
- 9 PË. E vërtetë.
- 10 PY. Ish-MUP-i?
- 11 PË. E vërtetë.
- 12 PY. Faleminderit.
- 13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund ta shohim pjesën e mbetur të
- 14 videos.
- 15 [Luhet videoincizimi]
- 16 ZNJ. IODICE: [Përkthim]
- 17 PY. Tani do kalojmë në një temë tjetër, Dëshmitar. A ju është
- 18 kërkuar ju ndonjëherë të kyçeni në SHIK?
- 19 PË. Po.
- 20 PY. Kush ua ka kërkuar këtë?
- 21 PË. Z. Ferhat Shala.
- 22 PY. Pse ua kërkoi ai ju këtë gjë?
- 23 PË. Nuk e di.
- 24 PY. Mesa keni ju dijeni, pse kërkonte ai që persona të
- 25 ndryshëm, përfshirë dhe ju të bëheshin pjesëtarë të SHIK-ut?

1 PË. Nuk e di.

2 PY. A ju kujtohet që e diskutuam bashkë këtë temë javën e  
3 kaluar?

4 PË. Po.

5 PY. A e mban mend çfarë the lidhur me këtë javën e kaluar, më  
6 konkretisht pse kërkonte z. Shala që persona të ndryshëm të  
7 bëheshin pjesëtarë të SHIK-ut?

8 PË. Ai ashtu ka ardh ka bisedu me mu. "Jemi të interesuar ta  
9 themelojmë ose do e themelojmë organizatën SHIK dhe jemi të  
10 interesuar për të gjetur njerëz".

11 PY. Po ai ua tregoi ju kush ia kishte dhënë atij këtë detyrë?

12 PË. Po mendoj që, po "Nga drejtori kam përgjegjësinë të  
13 bisedoj me ju, të përzgjedhë njerëz, të bisedoj me ju".

14 PY. Kush ishte drejtori?

15 PË. Po me siguri në atë kohë ka qenë z. Kadri Veseli.

16 PY. Faleminderit. Po përpara kësaj periudhe, mesa keni ju  
17 dijeni, Ferhat Shala ka qenë i UÇK-së?

18 PË. Po, ka qenë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Znj. Iodice, nuk e kam të  
20 qartë pyetjen tuaj, a e pyetët dëshmitarin kush, kur i është  
21 bërë kërkesa Ferhat Shala? Ju lutem, sqarojeni këtë.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Do ta sqaroj.

23 PY. Dëshmitar, përpara se të flasim për rolin e Ferhat Shalës  
24 në UÇK, a mund të na thoni me përparësi kur ka ardhur Ferhat  
25 Shala dhe ju ka kërkuar të kyçeshit në UÇK nga pikëpamja

Dëshmitari: Nezir Çoçaj (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 28

1 kohore?

2 PË. Po mendoj ka qenë viti 2001.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] S'isha unë shumë i qartë.

4 Unë në fakt desha të dija nëse mund të na thotë dëshmitari kur  
5 i është kërkuar Ferhat Shalës nga drejtori i SHIK-ut të  
6 krijonte strukturën.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, jeni në gjendje t'i përgjigjeni ju kësaj? Kur,  
9 pra, ia ka kërkuar drejtori i SHIK-ut Ferhat Shalës të  
10 krijonte këtë strukturë të SHIK-ut?

11 PË. Ferhati më ka thënë në vitin 2001. Gjëra tjera nuk di.

12 PY. Faleminderit. Ju thatë që, mesa keni ju dijeni, Ferhat  
13 Shala ka qenë anëtar i UÇK-së. A e dini në cilën zonë ka  
14 vepru?

15 PË. E di që ka qenë në Zonën Operative të Drenicës.

16 PY. Mesa keni ju dijeni, a ka pasur ndonjë nofkë?

17 PË. Mesa di, ka qenë me nofkën Pëllumbi.

18 PY. Faleminderit.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, bëjmë  
21 dhjetë minuta pushim.

22 Dëshmitar, mund të dilni nga salla e gjyqit për momentin  
23 për dhjetë minuta.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë

1 minuta pushim.

2 --- Seanca ndërpritet në orën 09.51

3 --- Seanca rifillon në orën 10.00

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A është e  
5 mundur, znj. Prokurore, që sa i takon shënimit përgatitor që  
6 diskutuam më herët për sa i takon dëshmitarit që planifikohet  
7 të hënën, a është e mundur që shënimi përgatitor të mund të  
8 dërgohet të enjten?

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do  
10 konsultohem dhe do ju jap një përgjigje më vonë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
12 vazhdoni.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Edhe një herë do konsultohem me  
14 kolegët dhe do ju them më vonë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.  
16 Tavakoli, nuk keni pyetje?

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo, nuk kam. Për momentin, jo.

18 Z. TULLY: [Përkthim] As ne nuk kemi pyetje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi. Nuk kemi pyetje.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk keni  
22 pyetje fare për këtë dëshmitar?

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, tani për momentin nuk kemi.

24 Megjithatë dua që të rezervoj të drejtën që të them në qoftë  
25 se kam ndonjë pyetje që mund të dalë nga pyetjet.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon, ajo  
2 çfarë do të bëjmë për ju është kjo, që do bëjmë pushimin tani.  
3 Dhe do rifillojmë në orën 1.30 dhe do vazhdojmë më pas me  
4 pyetjet tuaja për këtë dëshmitar në orën 1.30. Pra, do ju  
5 japim pak kohë në mënyrë të tillë që ju të përgatiteni dhe të  
6 bëni pyetjet e nevojshme dhe të konsultoheni me shënimet  
7 përgatitore.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Ju jam mirënjohës, të nderuar  
9 Gjykatës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Dhe doja  
11 t'ju them që ne planifikojmë që me këtë dëshmitar të mund të  
12 përfundojmë sot. Kjo është edhe për ju, z. Ellis, përderisa ju  
13 mund të keni disa pyetje të tjera plotësuese dhe keni parasysht  
14 dhe faktin që edhe Gjykatësit mund të kenë disa pyetje për  
15 këtë dëshmitar.

16 Z. TULLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne nuk po themi  
17 që kemi pyetje fare.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] në rregull. E  
19 kuptoj këtë gjë, po thjesht doja të them dhe një herë që  
20 planifikojmë që me këtë dëshmitar të përfundojmë sot.

21 Atëherë do bëjmë pushim deri në orën 1.30. Faleminderit  
22 për vëmendjen deri tani dhe do shikohemi më vonë.

23 --- Pauza fillon në orën 10.03

24 --- Seanca rifillon në orën 13.30

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të

1 fillojmë me kundërpyetjet e dëshmitarit të sotëm W04679, kemi  
2 dy urdhra me gojë.

3 Trupi Gjykses rikujton se më 11 nëntor 2024, në  
4 parashtrimin e protokolluar F02706, Mbrojtja kërkoi  
5 bashkërisht leje për ta apeluar urdhrin e tretë të Trupit  
6 Gjykses, të datës 31 tetor 2024, që përkatësisht ishte një  
7 urdhër me gojë që pranonte si pjesë të provave gjyqësore  
8 dokumentin V00008.

9 Pasi morëm parashtrimet e të gjitha palëve, Trupi Gjykses  
10 konstaton se nuk janë arsye të vlefshme pse është dorëzuar me  
11 vonesë kjo kërkesë. Edhe parashtrimi i protokolluar F02706  
12 është dorëzuar jashtë afateve që janë parashikuar në rregullën  
13 77(1), dhe për rrjedhojë e rrëzon kërkesën e Mbrojtjes për  
14 shkak se është dorëzuar jashtë afatit.

15 Tani do të japim një urdhër me gojë sa i takon  
16 materialeve që vendosen në listën e *Legal Workflow* për  
17 avokatët kujdestarë.

18 Në parashtrimin F02727, ZPS-ja ka kërkuar që Trupi  
19 Gjykses të ketë, të vendosë disa garanci sa u takon qasjeve që  
20 duhet të kenë avokatët kujdestarë në materialet që janë në  
21 listat e prezantimeve, listat e materialeve. Edhe duhet,  
22 avokati kujdestar duhet të shohë vetëm deklaratat e mëparshme  
23 të dëshmitarit dhe të mos shqyrtojë asnjë nga dokumentet e  
24 mëtutjeshme që gjenden në listën e materialeve. Edhe palët dhe  
25 pjesëmarrësit duhet të njoftohen paraprakisht, ndërkohë do t'u

1 jepet mundësia që të bëjmë parashtrime sa i takon kërkesave që  
2 mund të kenë Avokatët kujdestarë lidhur me këto garanci.

3 Trupi Gjykues dëgjoi parashtrimet e të gjitha palëve sot  
4 paradite që janë pasqyruar edhe në transkriptin e ditës së  
5 sotme në faqen dhe rreshtin 12, faqja 5, rreshti 19.

6 Mbrojtja e kundërshtoi kërkesën, Mbrojtja vlerëson se  
7 është e rëndësishme që dhe avokatët kujdestarë të shqyrtohen,  
8 të njihen me materialet që janë në listën e materialeve,  
9 përpara se të japin dëshminë dëshmitarët në mënyrë që avokati  
10 kujdestar të jetë në gjendje t'i japë këshillat e duhura  
11 klientit të vet. Së dyti, sa i takon arsyes që jep ZPS-ja për  
12 ndjeshmërinë e këtyre materialeve, dhe rëndësinë që kanë këto  
13 materiale, Mbrojtja thotë që avokati kujdestar sigurisht që  
14 respekton kodin e etikës së një avokati dhe respekton të  
15 gjitha masat e përcaktuara në të.

16 ZPS-ja u përgjigj se duke i dhënë materialet avokatit  
17 kujdestar, nuk ndihmon fare për efikasitetin e procesit  
18 gjyqësor, sepse çështjet e vetë-inkriminimit nuk burojnë nga  
19 materialet që gjenden në listën e materialeve, por burojnë nga  
20 pyetjet që i bënë palët.

21 Pasi morëm parashtrimet e të gjitha palëve dhe  
22 pjesëmarrësve, Trupi Gjykues vlerëson se parimisht një avokat  
23 kujdestar duhet të ketë qasje në të gjitha materialet që  
24 gjenden në listën e materialeve të Prokurorisë më së paku 24  
25 orë përpara fillimit të dëshmisë së klientit të tyre. Trupi



1 Gjykues vlerëson se kjo i jep mundësi avokatit kujdestar të  
2 shqyrtojë materialet dhe kështu mund t'i japë këshilla të  
3 vlefshme dhe efikase klientit të vet sa i takon aspekteve që  
4 lidhen me vetë-inkriminimin. Kjo sigurisht na ndihmon edhe ne  
5 që të mos kemi vonesa të panevojshme gjatë procesit gjyqësor.

6 Trupi Gjykues thekson se avokati kujdestar nuk duhet të  
7 diskutojë me askënd përmbajtjen e materialeve që ka marrë për  
8 hir të përfaqësimit të klientit të tyre me asnjë palë të tretë  
9 dhe as me publikun. Avokati kujdestar nuk duhet t'i japë asnjë  
10 këshillë klientit të vet sa i takon dëshmisë lidhur me  
11 materialet që kanë shqyrtuar paraprakisht. Avokati kujdestar  
12 ka një kuadër të kufizuar dhe këshillat i jep vetëm lidhur me  
13 aspektet që lidhen me vetë-inkriminimin dhe që mund të dalin  
14 gjatë dëshmisë.

15 Atëherë, Trupi Gjykues udhëzon Zyrën Administrative që të  
16 informojë avokatët kujdestarë lidhur me këtë.

17 Në rast se ZPS-ja ka ndonjë arsye më konkrete pse avokati  
18 kujdestar nuk duhet të shqyrtojë një material konkret në  
19 listën e materialeve, atëherë ZPS-ja duhet të njoftojë Trupin  
20 Gjykues dhe t'i japë arsyetimin përkatës. Në rast se avokati  
21 kujdestar kërkon një ndryshim të kushteve që sapo citova,  
22 atëherë Trupi Gjykues do të vendosë rast pas rasti dhe pasi të  
23 ketë marrë parashtrime të të gjitha palëve.

24 Dhe do të vijojmë me kundërpyetjet nga Mbrojtja, do të  
25 fillojmë sot me Mbrojtjen e Veselit. Më pas nga Mbrojtja e z.

Dëshmitari: Nezir Çoçaj (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 34

1 Thaçi, z. Selimi dhe z. Krasniqi.

2 Ju lutem, sillni dëshmitarin në sallë.

3 ZNJ. IODICE: [Nuk ka përkthim].

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Sa i takon shënimit përgatitor të

6 Dëshmitarit W03873, ne parashikojmë që mund të japim këto

7 shënime deri të enjten dhe do t'u japim përditësimet përkatëse

8 në momentin e duhur.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,

12 tani do të fillojmë me pyetjet nga ekipet e Mbrojtjes. Edhe do

13 të fillojë Avokati i z. Veseli. Dëgjojeni me vëmendje ju

14 lutem, janë në të djathtën tuaj.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

16 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

17 Z. DIXON: [Përkthim]

18 PY. Mirëdita z. Çoçaj. Unë quhem Rodney Dixon. Unë përfaqësoj

19 z. Kadri Veseli këtu dhe do t'ju bëj disa pyetje.

20 Do të doja z. Çoçaj, të flisnim për periudhën kur filloi

21 konflikti në mars të 1998. Asokohe, ju qëndronit në fshatin

22 tuaj, apo jo? Që është në kufi me Shqipërinë, apo jo, është në

23 jugperëndim, në Gjonaj, kështu?

24 PË. E vërtetë.

25 PY. Ju më përpara keni qenë mësues, arsimtar, kështu?

1 PË. Po, isha pedagog shkolle.

2 PY. Në mars të 1998-s, keni qenë nga personat e parë në  
3 fshatin tuaj që keni filluar të organizonit mbrojtjen e  
4 fshatit tuaj, apo jo, për shkak të masakrave që kishin ndodhur  
5 në vende të tjera të Kosovës? Kur themi masakra kemi fjalën  
6 për masakrat që kryen serbët kundër shqiptarëve, kështu?

7 PË. E vërtetë. Por nuk isha i pari, por isha në mesin e të  
8 parëve.

9 PY. Po, faleminderit. Ju keni ndihmuar vullnetarisht bashkë  
10 me të tjerët për të mbrojtur fshatin tuaj në mars të 1998,  
11 kështu?

12 PË. Në fakt nuk ka pas konflikt të drejtpërdrejtë në fshatin  
13 tonë, mirëpo krahas rrjedhave në fshatrat të tjera, në pjesë  
14 të tjera të Kosovës, është pritur që mund të ketë të njëjtat  
15 situata, të njëjtat problematika që i kanë pas fshatrat në  
16 pjesë të tjera të Kosovës.

17 PY. Po, dhe fshati juaj ka qenë një prej shumë fshatrave në  
18 kufi pranë Hasit, në zonën e Hasit, kështu?

19 PË. Po, ne jemi në zonën e Hasit dhe Hasi është pjesë e,  
20 domethënë, sipërfaqja e Hasit bën pjesë në komunën e  
21 Prizrenit, në komunën e Gjakovës, dhe në Krumë të Shqipërisë  
22 të Republikës së Shqipërisë. Pra, kufizohemi me Republikën e  
23 Shqipërisë.

24 PY. Pikërisht, po. A mund të sqarojmë diçka sa i takon  
25 formacionit që kishit ju asokohe? E kam fjalën për mars,

1 prill, maj, të atij viti. Struktura ka qenë e paformuar mirë,  
2 ishte thjesht një strukturë që e drejtonte Ramush Hadri --  
3 ishte koordinator në zonën tuaj.

4 PË. Po, koordinator regjional i shtabit 1000 Hasi ishte  
5 Hajrush Muhadri, jo emrin të cilin e potencoi, e theksoi  
6 përkthyesja. Hajrush Muhadri. Ky është emri i vërtetë i  
7 personit përgjegjës.

8 PY. Po, në fakt ishte faji im, ju kërkoj unë ndjesë. Hajrush  
9 Muhadri ka qenë koordinatori në regjionin tuaj. Po në fshatin  
10 tuaj, kush ishte përgjegjës?

11 PË. Në fshatin tim përgjegjës ishte Zenun Çoçaj, tanimë  
12 dëshmor i kombit.

13 PY. Z. Zenun Çoçaj, ka qenë axha i z. Hajrush, kështu?

14 PË. Ishte daja i z. Hajrush.

15 PY. A është e vërtetë që shumë prej organizimeve në ato kohë  
16 bëheshin mes familjarëve, mes shokëve që e njihnin njëri-  
17 tjetrin, dhe bashkoheshin për të mbrojtur fshatrat? A ka qenë  
18 kështu?

19 PË. E vërtetë.

20 PY. Në atë kohë, dhe kur them në atë kohë, e kam fjalën për  
21 periudhën mars prill maj, në atë kohë nuk ka pasur një  
22 organizim qendror, por keni punuar në fakt, keni funksionuar  
23 fshat për fshat, të veçuar, kështu?

24 PË. Po. Sa i përket fshatit, domethënë, po.

25 PY. Dhe në të vërtetë ka qenë shumë e vështirë madje të

1 shkoje nga një fshat tek tjetri në atë periudhë për arsye të  
2 sigurisë, e saktë?

3 PË. E saktë.

4 PY. A është e vërtetë që në atë kohë nuk ekzistonte Shtabi i  
5 Përgjithshëm i UÇK-së që t'ju jepte direktiva fshatrave apo të  
6 urdhëronte njerëzit se të vepronin?

7 PË. Është e vërtetë. Nuk ka pas mundësi Shtabi i Përgjithshëm  
8 me dhanë instruksione për secilin fshat.

9 PY. Ju personalisht nuk keni marrë ndonjë instruksion në këtë  
10 periudhë nga Shtabi i Përgjithshëm apo nga ndonjë person të  
11 Shtabit të Përgjithshëm, kështu?

12 PË. E vërtetë. Nuk kemi pas instruksione. Nuk e kam dit as  
13 nuk e kemi dit që ekziston Shtabi i Përgjithshëm në atë kohë.

14 PY. Ju kryesisht fokusoheshit tek mbrojtja edhe të ish  
15 pjesë e frontit, në qoftë se ishte nevoja, kështu? Frontit të  
16 luftës.

17 PË. E vërtetë.

18 PY. Sa i përket ushtrimeve që keni kryer, ju nuk keni kryer  
19 ndonjë stërvitje ushtarake apo jo? Thjesht jeni përpjekur sa  
20 të mundeshit me armët që kishit, kështu?

21 PË. Nuk kemi pas përgatitje të duhur ushtarake.

22 PY. Shumë persona në fshatin tuaj u bashkuan për mbrojtjen e  
23 fshatit se ishin tejet të zemëruar për shkak të masakrave që  
24 po ndodhnin në Kosovë, është e saktë?

25 PË. E saktë.

Dëshmitari: Nezir Çoçaj (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 38

1 PY. Por këta persona nuk është se kishin ndonjë formim  
2 ushtarak kur u kyçën, a është ky një vlerësim i drejtë?

3 PË. E drejtë, e saktë.

4 PY. E lëmë mënjanë këtë periudhë kohore dhe flasim për  
5 periudhën e verës të 1998. Në këtë kohë, kanë ndodhur disa  
6 ofensiva serbe në zonën tuaj, në kufirin me Shqipërinë, por  
7 dhe në zonat rreth e rrotull. A ju kujtohen këto?

8 PË. Po, ka pas ofensiva.

9 PY. Zona kufitare ku ishit ju ishte e rëndësishme për ju  
10 sepse ishte pikërisht zona ku kalonit armët nga Shqipëria, apo  
11 jo?

12 PË. E vërtetë.

13 PY. Në dëshminë që i keni dhënë ZPS-së, në pjesën 1, faqja 16  
14 në vijim, ju keni thënë që gjatë kësaj kohe me z. Muhadri dhe  
15 të tjerë, Hajrush Muhadri e të tjerë, ka pasur ulje dhe  
16 ngritje në organizatën tuaj. A ju kujtohet kjo dëshmi?

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund t'iu tregoni dëshmitarit  
18 pjesën përkatëse?

19 Z. DIXON: [Përkthim] Unë ju dhashë referencën. Është  
20 vetëm një fjali që thuhet: lart e poshtë.

21 DËSHMITARI: E vërtetë është kjo.

22 Z. DIXON: [Përkthim]

23 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Ju kujtohet, po. Kur thoni ju ka  
24 pasur ulje e ngritje në organizatë, çfarë keni dash të thoni  
25 ju konkretisht?

1 PË. Po, pas çdo ofensive, domethënë, niveli i motivimit të  
2 personave ka qenë i ndryshëm. Dhe disa, me siguri edhe në bazë  
3 të rrethanave të tyre familjare, ekonomike, janë zbeh, janë  
4 tërhjek nga organizimi i mirëfilltë, i duhur. Në këtë kuptim e  
5 kam thanë.

6 PY. Faleminderit. A është e vërtetë që z. Muhadriu që ju  
7 përmendët, ka qenë një prej personave që u tërhoq nga  
8 organizata pas ofensivës serbe të shtatorit 1998?

9 PË. E vërtetë.

10 PY. Pra, ju nuk keni pasur koordinator më, dhe nuk keni pasur  
11 më strukturë në atë kohë. Flasim për periudhën pas ofensivës  
12 serbe të shtatorit të 1998, saktë?

13 PË. Në një farë mënyre, ka pas zbehje të strukturës, por kanë  
14 qenë persona të tjerë që kanë vazhdu aktivitetin. Saktësisht  
15 për z. Hajrush Muhadri, nuk e di, nuk e di çka, me çka është  
16 marrë pastaj, me çka ka vazhdu pastaj.

17 PY. Kush ish in atëherë personat që morën kontrollin në zonën  
18 tuaj kur u largua ai, në zonën e, në regjionin e Hasit, kur u  
19 largua ai?

20 PË. Ai ka qenë Qazim Muhadri, Gasper Karaqi, e të tjerë.

21 PY. A është e vërtetë që më pas, pas ofensivave serbe, në  
22 shtator të 1998, a është e vërtetë që ju vendosët të  
23 kontaktonit me komandant Drinin të zonës së Pashtrikut, nën-  
24 zonës së Pashtrikut asokohe, për të parë mundësinë që të  
25 riorganizoheshit?

1 PË. Është e vërtetë.

2 PY. Ju shkuat për ta takuar komandant Drinin kur u kthye ai  
3 nga Shqipëria nga mesi i dhjetorit 1998. A ju kujtohet që  
4 shkuat ta takonit?

5 PË. Po, më kujtohet.

6 PY. Cili qe qëllimi i atij takimi në mes të dhjetorit të  
7 1998?

8 PË. Qëllimi ka qenë --

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund të na jepet më e saktë  
10 periudha e mes dhjetorit?

11 Z. DIXON: [Përkthim] E pyeta dëshmitarin, dhe i kujtohet.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
13 kundërshtimi i Prokurorisë.

14 Vazhdoni, Dëshmitar.

15 DËSHMITARI: E di që kemi shku ta takojmë dikënd nga  
16 komanda e zonës, për arsye se kemi dashtë funksionim ma të  
17 mirëfilltë, ma të duhur, ma të mirë të shtabit regjional 1000  
18 Hasi. Dhe synimi ynë ka qenë shndërrimi nga shtabi në brigadë.

19 Z. DIXON: [Përkthim]

20 PY. Që ta sqarojmë. Në atë kohë nuk ka pasur përfshirje të  
21 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në këto diskutimet që keni  
22 pasur ju, apo qoftë në proceset që po ndiqni ju, kështu?

23 PË. Nuk ka pas, nuk di që ka pas involvime të Shtabit të  
24 Përgjithshëm në këtë proces.

25 PY. A është e vërtetë që në këtë periudhë kohore, pra,



1 dhjetor, mesi i dhjetorit na intereson, a është e vërtetë,  
2 pra, që komandant Drini të ka kërkuar ty që të kyçeshe në  
3 shërbimin e zbulimit në nivelin e zonës, ju kujtohet?

4 PË. Kjo është e vërtetë. Por fillimisht ka kërkuar që unë në  
5 një farë forme të merrem me logjistikë, thjesht ngase isha nga  
6 rajoni i Hasit, nga regjioni i Hasit, dhe mundësitë për të  
7 shkuar të kërkuar ndihma financiare tek hasianët që punonin  
8 jashtë Kosovës. Kjo ka qenë kërkesa fillestare e komandant  
9 Drinit për mua.

10 PY. Po çfarë ndodhi pastaj, e kryet ju këtë detyrë, e morët  
11 ju përsipër këtë detyrë?

12 PË. Jo, nuk e kam marrë përsipër këtë detyrë.

13 PY. A është e vërtetë që ai ju propozoi dhe pozita të tjera?  
14 Për shembull tha mund të merreni me logjistikën, kështu?

15 PË. Po, kështu ka qenë. Kërkesa e parë e tij.

16 PY. Përfundimisht, ju patët një rol në sektorin e zbulimit të  
17 zonës, apo jo? A ndodhi kështu?

18 PË. Po, kështu ka ndodh. Me kërkesën e komandant Drinit ai ma  
19 propozoi që duhesh, është mirë të punosh në këtë sektor dhe  
20 prandaj dhe unë pranova.

21 PY. Po a ua shpjegoi ndonjëherë ai pse mendonte ai që do të  
22 ishte që ju të punonit në atë sektor?

23 PË. Tash, arsyet nuk i di të drejtpërdrejta pse, mirëpo ngaqë  
24 dhe kishim komunikim dhe kishim njoftuesi përmes një familjari  
25 të tij me të, ndoshta dhe për shkak të besimit që ka pas ndaj

1 meje. Por saktësisht nuk i di arsyet çfarë ka pa ai të

2 arsyeshme që unë të punoj në këtë sektor.

3 PY. A është e vërtetë që një shoku juaj, një person që ju e

4 njihnit, njihnte një prej anëtarëve të familjes së tij, edhe

5 mbi këtë bazë vendosi ai t'ua kërkonte që të kryenit këtë

6 detyrë? Ju kujtohet kështu?

7 PË. Shoku im e njihnte komandant Drinin drejtpërdrejt, ishte

8 familjar i tij. Andaj edhe unë kam, besoj që kjo ka qenë dhe

9 arsyeja e propozimit të drejtpërdrejtë.

10 PY. Faleminderit për sqarimin. Kur u caktuat në këtë rol, në

11 këtë pozitë, a ju dhanë ndonjë emërim me shkrim apo gjithçka u

12 zhvillua me gojë?

13 PË. Jo, nuk kam pas emërim me shkrim, vetëm me gojë,

14 domethënë.

15 PY. Dhe përveç komandant Drinit, nuk ju emëroi ndonjë person

16 tjetër, dhe kur them ndonjë person tjetër, ndonjë nga Shtabi i

17 Përgjithshëm?

18 PË. Jo, jo.

19 PY. A mund të na ndihmoni ta kuptojmë kush ka qenë tjetër në

20 zonë i përfshirë me zbulimin në kohën kur jeni caktuar ju, kur

21 jeni emëruar ju? Kush merrej tjetër me zbulimin në zonën tuaj?

22 PË. Kur jam caktuar unë, nuk kam pa dikënd edhe nuk kam pas

23 emërim të një pozite të posaçme, thjesht shef apo zëvendës

24 shef, apo anëtar i thjeshtë, apo, të merresh me këtë, pastaj

25 do jua sqarojmë, pastaj do vijmë. Mbas disa kohësh ka ardh

- 1 Halil Qadraku dhe Peka Gashi. Po ashtu pas, rreth muajit  
2 prill, ka qenë Xhavit Bajraktari.
- 3 PY. A mund të na e thoni dhe një herë, ju lutemi, emrin e  
4 personit të tretë, sepse përkthyesi nuk e dëgjoi?
- 5 PË. Peka Gashi.
- 6 PY. Personi i dytë ky. Po përmendët dhe dikë tjetër, thatë z.  
7 Qadraku, z. Gashi, Peka Gashi? Por përmendët, këta ishin vetëm  
8 të, këta ishin të vetmit persona në sektorin e zbulimit.
- 9 PË. Po. Fillimisht, znj. Gashi, është zonjë, është femër.  
10 Znj. Peka Gashi, nuk e di emrin e plotë, kërkoj falje, por nuk  
11 e di emrin e plotë të saj, por Peka i kemi thanë të gjithë.  
12 Por është zonjë, nuk është zotëri.
- 13 PY. Po, në rregull. A është e vërtetë që z. Qadraku ka qenë  
14 shefi i sektorit të zbulimit në nivel zone dhe zonja ka qenë  
15 asistente ose administratore?
- 16 PË. E vërtetë është.
- 17 PY. Ju e keni filluar ushtrimin e detyrës bashkë me ta nga  
18 janari i 1999, saktë?
- 19 PË. Faktikisht, i bjen që unë kam qenë ma herët i kyçur, por  
20 s'kam pas emërim të caktuar të shefit, apo të drejtorit, apo  
21 si t'i thuash, në nivel të zonës.
- 22 PY. Pra, ju filluat të punonit për z. Qadraku që nga janari i  
23 1999, saktë?
- 24 PË. Besoj se ka qenë janar kur ka ardh z. Qadraku. Ashtu i  
25 bjen. Por nuk e di saktësisht.

1 PY. A është e saktë që me sa keni ju dijeni, përpara janarit  
2 të 1999, nuk ka pasur ndonjë strukturë të zbulimit në nënzonën  
3 e Pashtrikut?

4 PË. Në nivel të zonës operative nuk e di që ka pas. Unë nuk e  
5 di.

6 PY. Ju nga janari i 1999, në fakt i keni ngritur gjërat nga  
7 zeroja në nivelin e zonës operacionale. E kam këtu për  
8 strukturën e zbulimit. Domethënë, me fjalë të tjera nga janari  
9 i 1999 e keni ngritur nga zeroja këtë strukturë, apo jo?

10 PË. Mendoj që po.

11 PY. Asokohe, pra e kam fjalën për janarin e 1999, ju keni  
12 pasur burime shumë të kufizuara në dispozicion për të bërë  
13 punë zbulimi. A është vlerësim i saktë ky?

14 PË. Është vlerësim i saktë.

15 PY. Ju nuk është se keni pasur rregullore për mënyrën e  
16 realizimit ose kryerjes së operacioneve të zbulimit, apo jo?

17 PË. Jo, nuk kemi pas rregullore.

18 PY. Më herët thatë se ju keni qenë pedagog dhe nuk është se  
19 keni pasur përvojë ose trajnim sa i takon punës së zbulimit,  
20 apo jo?

21 PË. Po, e vërtetë.

22 PY. Përgjegjësia kryesore e juaja në atë kohë dhe po ashtu  
23 edhe në muajt në vijim, ishte të mblidhnit sa më shumë  
24 informacion që të kishit mundësi lidhur me pozicionet serbe,  
25 forcat e tyre, dhe se ku mund të sulmonin ata. A ka ndodhur

1 kështu në realitet në atë kohë?

2 PË. Po.

3 PY. Kur e merrnit këtë informacion, çfarë bënit? Ia kalonit  
4 apo ia përcillnit atë eprorëve tuaj, domethënë, ia kalonit z.  
5 Qadraku, eprorit tuaj?

6 PË. Po, nëse ishte z. Qadraku aty, po. Pastaj ka shku me  
7 hierarki. Shefi i operatives, shefi i shtabit në nivel të  
8 zonës dhe pastaj kupola që ka qenë zëvendëskomandanti e  
9 sidomos komandanti i zonës. Pra, në këtë farë vije kemi lëviz,  
10 kemi shku, me informacionet.

11 PY. Po. Pra, në qoftë se nuk ia përcillnit informacionin z.  
12 Qadraku, kujt ia përcillnit informacionin e mbledhur?

13 PË. Kryesisht, domethënë, ka qenë fokusi te komandanti i  
14 zonës, nëse ka qenë aty. Nëse jo, kemi përcjellë hierarkinë.  
15 Zëvendëskomandanti, shefi i shtabit dhe shefi i operativës,  
16 kështu janë kujt disi në këtë mënyrë. Pra, ata kanë qenë ata  
17 që kanë, kanë bo plane, kanë përcaktu edhe detajet në secilin  
18 plan, ku kanë lëviz forcat serbe, ku mund të jenë, e të tjerë  
19 e të tjerë.

20 PY. Si e përcillnit ju këtë informacion? Me shkrim, me gojë,  
21 me të dyja? Na e shpjegoni pak.

22 PË. Po, kryesisht me gojë, por dhe me shkrim. Domethënë i  
23 kemi pas të specifikume në mënyrë që t'i shënojmë ku kanë  
24 lëviz, për të pas njohurinë operativa e komandës së zonës.

25 PY. I shkruanit me dorë, me shkrim dore?

1 PË. Po.

2 PY. Po për komunikatat? Domethënë, komunikimet, si  
3 realizoheshin komunikimet? Komunikimet bëheshin përmes  
4 radiolidhjeve, fizikisht, ballë për ballë me njëri-tjetrin? Si  
5 ndodhnin?

6 PË. Po në të dy mënyrat. Por kryesisht me radiolidhje, por ka  
7 pas mundësi ata që kanë qenë me territor afër, ka mund të  
8 raportojnë edhe me gojë. Po ashtu ka pas mundësi që lëvizja e  
9 ndonjë eprori në një nga territoret e afërta ka mujt me  
10 paraqit, domethënë, verbalisht se nga informacionet që kanë  
11 marrë në terren, forcat kanë mund të lëvizin ose të jenë në  
12 pozicion të caktuar.

13 PY. Këtë informacion lidhur me pozicionet serbe, e keni marrë  
14 nga personat në terren, në batalione? Domethënë ata të cilët  
15 luftonin në vijën e frontit, nga këto burime e merrnit, është  
16 e saktë kjo?

17 PË. Po, informacioni ka mujt me ardh nga shumë persona, por  
18 sidomos nga njësitë taktike në terren, operative në terren që  
19 kanë qenë nga një skuadër togu, nga persona përgjegjës që janë  
20 marrë me vëzhgimin e pozicioneve serbe, lëvizjet e pozicioneve  
21 serbe, apo të makinerisë ushtarake serbe në terren. Domethënë,  
22 se ka qenë komandant batalioni, ka mund me qenë një person i,  
23 komandant, një ekipës, një togut, ose edhe te të tjerët.

24 PY. Pastaj, në këtë kohë, z. Çoçaj, edhe ju keni luftuar vetë  
25 në vijën e frontit, apo jo? Dhe çfarë do të thotë që luftimet

1 në vijën e frontit ju zinin një pjesë të konsiderueshme të  
2 jetës suaj të përditshme, kështu?

3 PË. Po, unë primar kam qenë ushtar. Edhe ushtar ka qenë  
4 gjithsecili, edhe komandanti i zonës ka qenë ushtar. Edhe kur  
5 ka pas ofensiva, kur ka pas ditë të luftimeve, faktikisht i ka  
6 ra që jemi nga 5.00 të mëngjesit, sepse në ora 5.00 në mëngjes  
7 zakonisht e kanë pas si orë, si traditë serbët me sulmu, kah  
8 5.00 të mëngjesit kemi qenë në vijë të frontit. Domethënë,  
9 detyra primare e imja ka qenë ushtar.

10 PY. Mbledhja e informacionit të zbulimit ka qenë një detyrë  
11 plotësuese, jo parësore, apo jo?

12 PË. E vërtetë.

13 PY. Na përshkruani si e mbledhjet informacionin, se si bënit  
14 raporte për këtë informacion. A është e saktë që ju asnjëherë  
15 nuk i keni dorëzuar këto raporte drejtpërsëdrejti te Shtabi i  
16 Përgjithshëm i UÇK-së, s'ia keni dhënë asnjëherë  
17 drejtpërsëdrejti Shtabi i Përgjithshëm të UÇK-së? Kjo është e  
18 vërtetë, apo jo?

19 PË. S'kam pas mundësi si t'ia jap Shtabit të Përgjithshëm  
20 këto informacione. S'ka qenë as detyrë e imja që t'ia jap  
21 Shtabit të Përgjithshëm këto informacione.

22 PY. Eprori juaj, z. Qadraku, me sa dini ju, as ai nuk është  
23 se i përcillte drejtpërsëdrejti informacionet te Shtabi i  
24 Përgjithshëm, apo jo?

25 PË. Nuk ka mund të ketë mundësi, pra s'ka pasur mundësi as ai

1 t'i dërgojë drejtpërdrejtë. Nuk ka qenë si sot lëvizja me  
2 mjete të lehta komunikimi, është dashtë në këmbë me shkue,  
3 disa kilometra nëpër zona malore ku kanë qenë edhe forcat  
4 serbe, pra ka qenë e pamundur lëvizja për me shku me dhanë  
5 informacione në Shtabin e Përgjithshëm.

6 Pastaj, cili ka qenë interesi i Shtabit të Përgjithshëm  
7 për me dit ku saktësisht ka një lëvizje të vogël apo të madhe  
8 të forcave serbe, me një territor të caktum?

9 PY. Me sa e dini ju, asnjë prej këtyre raporteve nuk është se  
10 u janë dorëzuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ju apo ndonjë  
11 person tjetër brenda grupit të zbulimit për Shtabin e  
12 Përgjithshëm, kjo është e vërtetë, apo jo?

13 PË. E vërtetë.

14 PY. Është e saktë të thuhet që informacioni që ju keni  
15 mbledhur nuk është kaluar ose nuk është përcjell në mënyrë të  
16 drejtpërdrejtë prej jush për z. Veseli në Shtabin e  
17 Përgjithshëm? Kjo është e vërtetë, apo jo, Dëshmitar?

18 PË. Unë, domethënë, z. Kadri Veseli e kam taku tri herë, por  
19 asnjherë nuk kemi pas biseda për këso gjanash. Domethënë, nuk  
20 di kush ka pas mundësi me taku, dhe kur ka pas nevojë ta  
21 takoj. Unë e them, jo.

22 PY. Ju jeni takuar me të për herë të parë në fund të marsit  
23 të 1999, kështu? Është e vërtetë kjo?

24 PË. Po, ka qenë -- s'e di saktësisht datën, por e di që pas  
25 fillimit të bombardimeve serbe me 24 mars, domethënë nga



1 forcat e NATO-s. Domethënë, si periudhë e lidhi me bombardimin  
2 e forcave të NATO-s.

3 PY. Sa për ta sqaruar, ka ndodhur pas fillimit të  
4 bombardimeve të NATO-s, domethënë atëherë ka qenë hera e parë  
5 kur jeni takuar me të, kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Ose që keni pas ndonjë kontakt me të -- pas fillimit të  
8 bombardimit të NATO-s?

9 PË. Pas -- pas 24 marsit, pra. Se më 24 kemi fillimin e  
10 bombardimeve serbe nga forcat e NATO-s, pas 24 marsit.

11 PY. Faleminderit. Dua t'ju pyes lidhur me rolin e sektorit të  
12 zbulimit për të identifikuar kolaboracionistët ose  
13 bashkëpunëtorët. Është e saktë, apo jo, që ju nuk keni pasur  
14 asnjë rast që lidhej me një bashkëpunëtor dhe me të cilin ju  
15 jeni marrë në pozicionin që kishit në nënzonë?

16 PË. E saktë është kjo.

17 PY. Ju prezumoni se në teori në qoftë se diçka nuk ishte siç  
18 duhej, domethënë, shërbimi inteligjent do e shqyrtonte këtë.

19 Por praktikisht, ju asnjëherë nuk jeni përfshirë në mbledhjen  
20 e informacion lidhur me personat që mund të kenë ndihmuar  
21 armikun, ose që mund t'i kenë kaluar, përcjellë, informacione  
22 armikut, a është kështu?

23 PË. Ashtu është.

24 PY. Ju asnjëherë, shefi juaj, z. Qadraku, nuk të ka thanë që  
25 të shkosh dhe të mbledhësh informacion për të ashtuqajturit

1 bashkëpunëtorë, kështu, apo jo?

2 PË. Asnjëherë s'më ka thënë, domethënë, ashtu është.

3 PY. As komandant Drini, asnjëherë s'ta ka kërkuar këtë gjë,  
4 që ta bënit këtë gjë, kështu?

5 PË. Jo, asnjëherë s'ma ka kërkuar.

6 PY. Po punën me policinë ushtarake në zonën tuaj, për  
7 mbledhjen e informacionit që kishte të bënte me krimet e  
8 kryera? Pra, a e keni kryer realisht këtë punë ndonjëherë?

9 PË. Asnjëherë.

10 PY. A keni punuar me policinë ushtarake në ndonjë farë forme  
11 ose trajte gjatë kohës kur keni qenë në sektorin e zbulimit?

12 PË. Jo.

13 PY. A kanë ndihmuar ata për t'ju transportuar diku, ose për  
14 të përmbushur funksionet tuaja, për t'ju ndihmuar për të  
15 përmbushur funksionet tuaja?

16 PË. Jo.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarisë të paraqesë  
18 në ekran një provë, një dokument, dhe do ju kërkoja që ta  
19 lexonit atë. Për Sekretarinë, është prova P500, në të dyja  
20 versionet, në shqip dhe në anglisht.

21 PY. Në të majtë mund të shihni që është një deklaratë në  
22 shqip. Pra, dokumenti është në shqip, titullin e ka  
23 "Deklaratë". Këtë dokument jua dërgoi, jua tregoi dhe  
24 Prokurorja, besoj që ju kujtohet kjo, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Këtë dokument ju thatë që nuk e keni parë asnjëherë  
2 përpara se t'jua tregonte Prokuroria. A është e vërtetë kjo?

3 PË. E vërtetë.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja e dytë e këtij  
5 dokumenti, në fund. Do i kërkoja Sekretares të kalojë te faqja  
6 tjetër në anglisht.

7 PY. Besoj që e shikoni në fund dokumentin ku thuhet, ku është  
8 një dokument i cili është nënshkruar nga shefi juaj, nga z.

9 Qadraku. A e shikoni nënshkrimin, Dëshmitar?

10 PË. Po.

11 PY. Nuk e di në qoftë se e njihni nëse ky është nënshkrimi i  
12 tij apo jo?

13 PË. Nuk e di. Nuk jam i sigurt nëse është nënshkrimi i z.

14 Qadraku.

15 PY. Ju thatë që këtë dokument nuk e keni parë më përpara.  
16 Çështja që ngre z. Qadraku në këtë dokument, ose çështjet që  
17 ngrihen në këtë dokument, a ju kujtohen të jenë diskutuar  
18 ndonjëherë me ju në atë kohë?

19 PË. Nuk e kujtoj. Nuk e kujtoj.

20 PY. Do ta them ndryshe fjalinë. A ju kujtohet që komandant  
21 Remi të ketë pasur ndonjë problem ndonjëherë -- ju kërkoj  
22 ndjesë, e thashë gabim, komandant Drini. Atëherë, ju kujtohet  
23 në qoftë se komandant Drini ka pasur probleme me sektorin  
24 tuaj, me sektorin e zbulimit në zonën tuaj? Ka pas ndonjë  
25 telash, ndonjë problem, ndonjë mosmarrëveshje me ju ai

1 atëherë?

2 PË. Nuk besoj të ketë pasur ndonjë mosmarrëveshje ose problem  
3 me sektorin tonë.

4 PY. Ju keni pasur marrëdhënie të mira me komandant Drinin,  
5 apo jo? Domethënë me aq marrëdhënie sa keni pasur, i keni  
6 pasur të mira këto marrëdhënie, apo jo?

7 PË. Konsideroj që po.

8 PY. Nuk e dëgjova përgjigjen që dhatë.

9 PË. Konsideroj që po.

10 PY. Tani dua t'ju tërheq vëmendjen në të majtë të dokumentit.  
11 Ju lutem, shikoni pak këto shifrat, një, dy, tre, që janë në  
12 të majtë të dokumentit në shqip. Dhe thuhet që është punuar në  
13 tri kopje. Dhe janë tri numra aty ku jepen institucionet ku  
14 jepen këto tri kopje. A e shikoni këtë listën këtu, Dëshmitar?

15 PË. Po. Po, e shikoj.

16 PY. Ndërkohë, 2 thuhet:

17 "Shtabit të Përgjithshëm."

18 Ndërkohë që tek numri 3 thuhet:

19 "SHIK-ut pranë Shtabit të Përgjithshëm,"

20 E shihni? Me sa ju kujtohet juve në atë kohë, a ka pasur  
21 SHIK pranë Shtabit të Përgjithshëm në atë periudhë?

22 PË. Nuk besoj që të ketë pasur SHIK në atë periudhë. Ka qenë  
23 ZKZ, por jo SHIK.

24 PY. Kur ju i referoheni SHIK-ut, e keni fjalën për  
25 organizatën ku jeni bërë pjesë në 2001, domethënë që ka qenë

1 shërbimi shtetëror inteligjent, për këtë është fjala kur  
2 përmendet SHIK-u?

3 PË. Po, besoj që po, sepse SHIK në atë kohë nuk ka pas, nuk  
4 kam dit që ka, dhe nuk është e mundur të ketë patur SHIK në  
5 atë kohë.

6 PY. A është e drejtë që kur SHIK-u u krijua për herë të parë,  
7 kjo ka ndodhur pas datës që mban kjo deklaratë, pra, që ka  
8 qenë në prill të 1999, pasi është nxjerrë kjo deklaratë. A ka  
9 qenë kështu?

10 PË. Nëse ka mundësi dhe njëherë se me përkthimin s'e pata të  
11 qartë.

12 PY. Patjetër. Po mundohem që të përcaktoj ca data këtu, dhe  
13 po ju pyes të më thoni se çfarë ju kujtohet. Pyetja është kjo:  
14 A është e vërtetë që SHIK-u është krijuar si institucion  
15 inteligjent kombëtar mbasi është botuar kjo deklaratë, kjo  
16 deklaratë që kemi këtu, dhe që SHIK-u është krijuar në prill  
17 të 1999? A është e vërtetë kjo?

18 PË. Unë nuk e di që ka pas SHIK në atë kohë. Tash, periudhën  
19 saktësisht nuk e mbaj mend kur është ba, tek janë ba, por  
20 funksionim të SHIK-ut nuk ka pas. Ne kemi qenë ZKZ, domethënë,  
21 zbulim-kundërzbulim i sektorit ushtarak.

22 PY. Sa për të qenë i qartë, në mars të 1999, që është koha  
23 kur ka dalë kjo deklaratë, domethënë, edhe një herë deklaratë  
24 është nxjerrë në mars të 1999. SHIK-u nuk ka ekzistuar  
25 atëherë, apo jo?

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtoj.

2 Z. DIXON: [Përkthim] Dua të sqaroj datat.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është hera e  
4 fundit që ju lejoj.

5 Kështu që mund të vazhdoni të jepni datat, Dëshmitar.

6 DËSHMITARI: Nuk jam i sigurt, nuk di saktësisht. Nuk di  
7 çfarë të them.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Nëse më lejoni do ju kërkoj që të  
9 paraqitet në ekran një tjetër dokument që është 1D70.

10 PY. Do ju kërkoj që t'i hidhni një sy këtij dokumenti,  
11 Dëshmitar, në mënyrë të tillë që të na thoni nëse e keni parë  
12 apo jo këtë dokument më përpara.

13 Kjo është një komunikatë, pra, mund ta lexoni në shqip në  
14 të majtë të ekranit, është komunikatë e qeverisë së Kosovës.  
15 Që është qeveria e përkohshme. Data është 2 prilli, është  
16 komunikatë e datës 2 prill 1999. Është një komunikatë publike.  
17 A ju kujtohet ta keni parë këtë dokument më përpara,  
18 Dëshmitar?

19 PË. Këtë dokument e kam parë në media pas luftës, jo para, jo  
20 gjatë luftës.

21 PY. Në rregull. A jeni në dijeni që në prill të 1999 është  
22 emëruar përbërja e qeverisë së përkohshme të Kosovës me  
23 ministrinë e shërbimit informativ të Kosovës? A jeni informuar  
24 që kjo ka ndodhur rreth kësaj periudhe, domethënë, në prill të  
25 vitit 1999?

1 PË. Domethënë, në lajme në Kosova -- në, e kemi pas radion  
2 tonë, ose si UÇK. Domethënë, atë e kam dëgju, mirëpo si  
3 dokument nuk e kam pa.

4 PY. Domethënë, ju kujtohet që e keni dëgju këtë në prill të  
5 1999, kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Do t'ju pyes lidhur me dëshminë që dhatë në pyetjet e  
8 Prokurores. Dhe kjo është tema e fundit që dua të cek me ju  
9 sot. Është një temë që ka të bëjë me z. Ferit Shalaj. A ju  
10 kujtohet që Prokuroria ju bëri disa pyetje lidhur me këtë  
11 person, sot paradite, Dëshmitar?

12 PË. Po, vetëm përkthyesja s'e ka emrin e saktë. Ferhat Shala.

13 PY. Është problemi i Avokatit, Dëshmitar. Ferhat Shala.  
14 Atëherë, Prokurori ju bëri pyetje lidhur me këtë person, me  
15 Ferhat Shalën, që kishte të bënte me kyçjen tuaj në SHIK,  
16 domethënë në shërbimin informativ kombëtar, në vitin 2001. A  
17 ju kujtohet kjo pyetje, Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 PY. A ju kujtohet, Dëshmitar, se kyçja juaj në SHIK ishte një  
20 çështje që është ngritur me ju, nga një mik i, shok i mirë i  
21 juaji, z. Skënder Saluka -- kështu e thotë Avokati emrin -- me  
22 të cilin ju keni shkuar në shkollë dhe keni ndjekur studimet  
23 universitare? Ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

24 PË. Po, unë shokun, Skënder Sallaukën e kam shok, mirëpo nuk  
25 kemi diskutuar rreth asaj të kyçjes në SHIK. Domethënë bisedën

1 e parë të drejtpërdrejtë për angazhim e kam pas me z. Ferhat  
2 Shala.

3 PY. A është një çështje kjo të cilën e keni diskutuar me  
4 shokun tënd, a ju kujtohet? E keni biseduar me të, me z.  
5 Skënder Saluka -- shqiptimi sipas asaj që tha Avokati.

6 PË. Nuk e di nëse kemi diskutuar me të. Nuk e mbaj mend.

7 PY. Në rregull. Kur keni biseduar me z. Shala, domethënë në  
8 2001, a e keni shprehur ndonjë interes të menjëhershëm për ju  
9 për t'u bashkuar me SHIK-un në atë kohë, ose për t'u bërë  
10 pjesë e SHIK-ut në atë kohë?

11 PË. Jo, nuk kam shpreh gatishmëri të menjëhershme, por pas  
12 disa takimesh jam dakorduar.

13 PY. Pra, t'u desh ca kohë për ta vlerësuar në qoftë se do  
14 bëheshit anëtar apo jo, do kyçeshit në SHIK, kështu?

15 PË. Po, kisha probleme familjare, shëndetësore, në familje,  
16 kështu më primare kam marrë funksionimin dhe ekzistencën e  
17 familjes, pastaj angazhimet e tjera.

18 PY. Është e drejtë, apo jo, që ju nuk e dinit në qoftë se z.  
19 Shala ishte përfshirë në sektorin e zbulimit gjatë luftës,  
20 kështu?

21 PË. Nuk e kam dit, nuk e di.

22 PY. Ju nuk keni pasur asnjëherë asnjë komunikim me të në  
23 rolin tuaj si pjesë e shërbimit të zbulimit gjatë luftës,  
24 kështu?

25 PË. Jo, nuk kam pasur.



1 PY. Ju nuk keni marrë asnjëherë asnjë urdhër apo udhëzime  
2 prej tij gjatë luftës, a është e drejtë kjo?

3 PË. Shumë e drejtë.

4 PY. Është e drejtë të thuhet, apo jo, që z. Veseli, me sa  
5 dini ju, nuk ka pasur zëvendësa që kanë punuar për të gjatë  
6 luftës? Është e saktë kjo?

7 PË. Nuk e di që ka pas. Nuk e kam dëgjuar asnjëherë.

8 PY. Pra, ju nuk e keni dëgjuar asnjëherë një gjë të tillë,  
9 domethënë, askush me sa kujtoni ju, me sa dini juve, nuk ka  
10 folur që ka pas ndonjë zëvendës të tij, kështu?

11 PË. E saktë.

12 PY. Faleminderit, Dëshmitar, nuk kam pyetje të tjera për  
13 juve.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

16 Tavakoli, keni pyetje?

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

18 Z. TULLY: [Përkthim] As unë nuk kam pyetje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

20 Z. ELLIS: [Përkthim] As unë nuk kam pyetje. Pyetjet e mia  
21 u mbuluan nga kolegu.

22 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
24 pushim prej 15 minutash përpara se sa të vazhdojmë më tej.

25 Dëshmitar, mund të largoheni nga salla për 15 minuta.

1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
3 mundohemi që të përfundojmë pas pushimit. Faleminderit, z.  
4 Dixon. Faleminderit që e mbaruat marrjen në pyetje të këtij  
5 dëshmitari në kohë rekord.

6 Tani do bëjmë një pushim prej 15 minutash dhe do të  
7 kthehemi përsëri në sallën e gjyqit. Do bëjmë pushim për 15  
8 minuta.

9 --- Pauza fillon në orën 14.27

10 --- Seanca rifillon në orën 14.44

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të  
12 vijë dëshmitari, duhet të kalojmë në seancë private.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jo.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
15 Barthe ka një pyetje për ekipin e Mbrojtjes së Veselit.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po. Faleminderit.

17 Kam një pyetje, z. Dixon për ju. Lidhur me një aspekt që  
18 trajtave në pyetjet tuaja me z. Çoçaj, është trajtuar dhe nga  
19 kolegët tuaj më përpara. Termi, domethënë, ky akronimi SHIK,  
20 në letrën e 14 marsit 1999 dhe dallimi mes terminologjisë SHIK  
21 dhe ZKZ, sepse na duket sikur e keni me shumë rëndësi këtë  
22 pjesë.

23 A po thoni ju që letra e 14 marsit '99, nuk është shkruar  
24 apo nënshkruar nga personat që kanë, janë autorë të kësaj  
25 letre, z. Halitjaha, z. Qadraku, dhe se ka qenë një letër e

1 fabrikuar sepse nuk ka pasur SHIK në mars të '99-s?

2 Z. DIXON: [Përkthim] Në fakt kjo është një nga temat që  
3 unë dua ta trajtoj me dëshmitarin e radhës më thellësisht.  
4 Sepse me këtë dëshmitar do ta trajtoj më konkretisht këtë  
5 dokument. Unë me këtë dëshmitar thjesht po përpiqesha të  
6 kuptoja se çfarë dinte ai për atë periudhë kohore. Dhe  
7 dokumente të tjera të ngjashme të periudhës së prillit.

8 Nuk po e shmang përgjigjen tuaj, por do të doja ta shihja  
9 se si do ta trajtojë Prokuroria këtë letër me dëshmitarin e  
10 radhës, sepse për ne kjo është shumë e rëndësishme.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Me sa kuptoj unë atëherë do  
12 marrim vesh më shumë javën tjetër.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Kështu shpresoj.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Mund të sillni  
15 dëshmitarin në sallë.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].  
18 [Përkthim] Ka pyetje më nga Prokurori?

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, nuk kem pyetje plotësuese.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Një çast.

22 Pyetje nga Trupi Gjykses:

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, z. Çoçaj.

24 Gjykatësit kanë disa pyetje të mëtutjeshme për ju, që të  
25 kuptojmë më mirë dëshminë tuaj. Pyetja e parë është e

1 përgjithshme. Ju lutem, a mund të na përshkruani si ka qenë  
2 situata në Prizren, në rrethinat e Prizrenit, në verën e '99-  
3 s, pasi u larguan forcat serbe?

4 PË. Domethënë, kjo pyetje e përgjithshme, situata si pas  
5 çlirimit të një vendit, si pas luftës. Pasojat e luftës janë  
6 vërejt kudo. Ne e kemi të pamundur një organizim të mirëfilltë  
7 pastaj. Secili nga ushtarët ka pas dhe probleme familjare,  
8 pamundësi të ekzistencës edhe financiare, të familjes. Jemi  
9 përpjekë pak a shumë të shkojmë nëpër objekte ku kanë qenë të  
10 caktuara apo të paracaktuara për të bërë punën dhe angazhimet  
11 tona si ushtarë. Nuk di çfarë të them tjetër pos rrethanave  
12 çfarë edhe dihen si një shtet që del, apo si një territor që  
13 del nga lufta në kushte të vështira të ekzistencës.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po rendi publik, siguria,  
15 kishte ende luftime? Flasim për qershorin e '99-s.

16 PË. Domethënë, pas 12 qershorit situata nuk ka pas konflikte  
17 sepse veç forcat serbe janë pothuajse larguar nga Kosova deri  
18 në 18 apo 20 qershor, domethënë, për në Prizren nga data 12  
19 apo 13, nuk ka pas, apo 14 qershor nuk ka pas prezencë të  
20 forcës ushtarake serbe dhe pastaj kemi ardhjen e forcave të  
21 KFOR-it. Dhe pothuajse kompetencat ekzekutive kanë kaluar nën  
22 KFOR-in gjerman. Po flas për zonën e Prizrenit.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptova. Z. Çoçaj, ne kemi  
24 dëgjuar nga dëshmitarë të tjerë lidhur me KFOR-in në -- kur  
25 hyri KFOR-i në Prizren, KFOR-i gjerman, më saktë, se UÇK-ja

1 kishte krijuar postblloqe, kishte bërë bllokime të rrugës

2 asokohe. A është kjo e vërtetë?

3 PË. Nuk mendoj se qëndron kjo.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju vetë nuk keni parë ndonjë  
5 postbllokt, ndonjë punk nga UÇK-ja?

6 PË. Jo, asnjëherë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk ju është dashur  
8 ndonjëherë, për shembull, të kalonit përmes një postblloku apo  
9 ndonjë punkti kur shkonit tek ish-ndërtesa e MUP-it?

10 PË. Jo, asnjëherë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kemi dëgjuar  
12 po ashtu, nga një dëshmitar se UÇK-ja është përpjekur të  
13 kontrollojë pikat e kalimit kufitar. Dhe kësaj [E  
14 pakuptueshme] shumë edhe Prokuroria. Keni dëgjuar ju për diçka  
15 të tillë?

16 PË. Nuk ka qenë e mundur kjo.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do t'ju jap më shumë  
18 hollësi. Një dëshmitar na ka thënë - dhe për procesverbal  
19 është në faqen 15696 të transkriptit - pra ka thënë që për  
20 herë të parë ka parë një postbllok të UÇK-së në pikën e  
21 kalimit kufitar të Morinës me Shqipërinë, pra, pika e kalimit  
22 kufitar me Shqipërinë më datën 13 dhe 14 qershor 1999, dhe  
23 sipas këtij dëshmitari, UÇK-ja është përpjekur të kontrollojë  
24 menjëherë pikat e kalimit kufitar pas tërheqjes së forcave  
25 serbe.

1 Nuk mund të na e konfirmoni diçka të tillë?

2 PË. KFOR-i gjerman ka qenë i vendosur më 12 qershor në pikën  
3 kufitare të Morinës. Dhe flamurin kombëtar shqiptar nuk e ka  
4 leju, sepse është përgjegjësi dhe kompetencë në bazë të  
5 marrëveshjes që KFOR-i gjerman të siguron çdo send. S'ka pas  
6 mundësi me pas forcë që iu afrohet KFOR-it gjerman dhe të bëjë  
7 pika kontrolli, sidomos në zonë apo dikund tjetër në  
8 territorin e çliruar. Domethënë, KFOR-i gjerman ka qenë  
9 jashtëzakonisht strikt, ka qenë. Ju e dini, e keni pa dhe në  
10 media që janë ballafaqu me forcë kundër ushtrisë jugosllave që  
11 kanë shfaq arrogancë ndaj urdhrave të KFOR-it gjerman.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, nuk na ndihmoni dot.  
13 Ose më saktë, nuk mund të na e shpjegoni dot pse mund të  
14 kishte pika të tilla, në fakt, dëshmitari vetë ka qenë --  
15 dëshmitari për të cilin po flisja unë, ka qenë ish-ushtar i  
16 KFOR-it. Ju po thoni që në qoftë se ka pasur postblloqe të  
17 UÇK-së nuk mund ta dini për çfarë arsye kanë qenë këto  
18 postblloqe?

19 PË. Të jem ma i qartë, unë nuk kam parë dhe nuk kam dëgjuar  
20 që pas çlirimit të Kosovës ka pas postblloqe nga Ushtria  
21 Çlirimtare e Kosovës, sidomos kur ka pas kompetencë KFOR-i  
22 gjerman. Ju thatë, ka qenë një video ku kanë qenë dy ushtarë  
23 serbë të ushtrisë serbe të vrarë për arsye të moszbatimit të  
24 urdhrit që ka dhanë KFOR-it gjerman.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Flasim tani

Dëshmitari: Nezir Çoçaj (Seancë private)  
Pyetje nga Trupi Gjykues

Faqe 63

1 për atë që ka ndodhur në ish-ndërtesën e MUP-it në mesin e  
2 qershorit 1999.

3 Ju lutem Sekretarisë të kalojmë në seancë private për  
4 mbrojtjen e dëshmitarit.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

24 jemi në seancë të hapur.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit Sekretares.

1 Faleminderit dhe Prokurores që ma kujtoi.

2 Dëshmitar, Ferhat Shala ka sugjeruar që Kadri Veseli i ka  
3 kërkuar atij që ta ndihmojë për të krijuar këto struktura të  
4 zbulim-kundërzbulim në vjeshtën e vitit 1998. A keni ndonjë  
5 arsye për të mos u pajtuar me këtë sugjerim?

6 PË. Jo. E theksova vjeshtën e vitit 1998. Ndërsa unë jam  
7 shprehur, kam thënë 2001. Pra, takimi me z. Ferhat Shala ka  
8 ndodhur pas lufte. Në 2001.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do kaloj tek takimi për  
10 pak. Megjithatë, ajo çfarë po them është kjo, që z. Ferhat  
11 Shala ka qenë, ka thënë gjithashtu që ka filluar detyrën që ta  
12 ndihmojë z. Veseli për krijimin e strukturës së zbulim-  
13 kundërzbulim në janar të vitit 1999. Përsëri pyetja është kjo:  
14 A keni ndonjë arsye për ta kundërshtuar këtë pretendim të  
15 tijin?

16 PË. Unë nuk e di çfarë ka thënë z. Ferhat Shala. Nuk bëhet  
17 fjalë për janar të '99-s, atë nuk e di, mund ta di vetëm z.  
18 Shala, po unë po flas për takimin që kam pas me z. Shala pas  
19 lufte në 2001. Nuk e di çfarë kompetence ka pas për ZKZ,  
20 atëherë ka qenë ZKZ, në janar të '99-s ka qenë strukturat e  
21 ZKZ-së, nuk ka pas të bëjë fare me SHIK. Nuk di si ka thon,  
22 ose si ka bisedu. Për ma tepër po besoj se mund t'i drejtoheni  
23 dikujt tjetër.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa i takon takimit tuaj të  
25 2001-shit me Ferhat Shalën, a mund të na thoni se çfarë roli

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nezir Çoçaj (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas  
Urdhrit Gojor të 25 nëntor 2024  
Pyetje nga Trupi Gjykses

Page 75

1 ka pasur ai ose çfarë posti ka pasur ai në atë kohë?

2 PË. Nuk ma ka thënë një gjë të tillë, dhe nuk kam pasur si ta  
3 di çfarë roli ka pas.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të konfirmoni që ai  
5 në atë kohë punonte për z. Veseli brenda organizatës që  
6 drejtonte z. Veseli, SHIK-un?

7 PË. Po besoj që ka punuar, po besoj që po.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mendoj që ju përmendët një  
9 nofkë që ai ka përdorur gjatë asaj kohe, Pëllumbi. Pasi është  
10 shpërbërë njësitit Pëllumbi, a e dini ju se çfarë funksioni  
11 apo çfarë roli ka luajtur z. Ferhat Shala? Domethënë, nga  
12 momenti që nuk ka qenë më pjesëtar, anëtar, ose shef i atij  
13 njësitit, çfarë roli ka kryer ai?

14 PË. Nuk e di.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jeni në dijeni në qoftë  
16 se ai ka ushtruar ndonjë funksion tjetër të ndryshëm nga  
17 funksionet e zbulimit?

18 PË. Nuk e di.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares  
20 tani të kalojmë në seancë private për Mbrojtjen e dëshmitarit.

21 ~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]Riklasifikuar sipas  
Urdhrit Gojor të 25 nëntor 2024

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Tani jemi në seancë  
23 private, të nderuar Gjykatës.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju pyes lidhur me  
25 diçka që thatë për Halil Qadrakun. Për procesverbal bëhet

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nezir Çoçaj (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas  
Urdhrit Gojor të 25 nëntor 2024  
Pyetje nga Trupi Gjykses

Page 76

1 fjalë për provën materiale P1835, që është shënimi përgatitor  
2 i seancës me Prokurorinë përpara një jave. Dhe e kam fjalën  
3 konkretisht për faqen 7, paragrafi 28 i procesverbalit të  
4 takimit që keni pasur me Prokurorinë. Ju keni thënë si më  
5 poshtë sipas këtij procesverbal. Dëgjoni njëherë dhe pastaj do  
6 ju bëj pyetje.

7 Këtu thuhet që ju keni thënë se:

8 "Halil Qadraku dhe [ti vetë] keni pasur detyra të njëjta.  
9 [Ju] nuk keni marrë asnjëherë pjesë në takime të zonës me z.  
10 Qadraku, dhe Halil Qadraku nuk ju ka informuar asnjëherë  
11 [juve] lidhur me gjëra konkrete në takime me përjashtim të  
12 rasteve kur bëhej fjalë për detyra të nivelit tuaj. Qadraku  
13 asnjëherë [juve] nuk iu ka treguar se çfarë ka raportuar, kujt  
14 i ka raportuar çfarë informacioni, sepse kjo ishte përtej  
15 nivelit që kishit [ju]."

16 Ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar, dhe a është e  
17 saktë kjo?

18 PË. Shumë e saktë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Halil Qadraku a të ka  
20 dhënë ty ndonjëherë informacion që ka mbledhur gjatë ushtrimit  
21 të detyrave të tij?

22 PË. Jo.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me sa keni dijeni ju, a e  
24 dini ju në qoftë se ai e ka ndarë në informacion të tillë me  
25 komandant Drinin? I ka dhënë ndonjë informacion të tillë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nezir Çoçaj (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas  
Urdhrit Gojor të 25 nëntor 2024  
Pyetje nga Trupi Gjykses

Page 77

1 komandant Drini?

2 PË. Nuk e di ç'ka është diskutu në mbledhjet e komandës së  
3 zonës, nuk mund të them asnjë send.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur thoni që ai nuk ju ka  
5 treguar asnjëherë se kujt i ka raportu dhe çfarë i ka raportu  
6 sepse kjo ishte mbi nivelin tuaj, çfarë keni dash të thoni  
7 konkretisht me këtë?

8 PË. Po me siguri s'e ka pasur të arsyeshme me më tregu apo me  
9 më informu mua, pastaj edhe nuk e di çfarë ka pas ndonjë send  
10 që ta veçon, ta thekson për të diskutuar me dikënd tjetër pos  
11 problemeve të luftës ato që faktikisht disa gjona që ka mujt  
12 me marrë prej meje me i përcjellë te komanda, te hierarkia.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtë pyetje kisha unë në  
14 fakt. Në qoftë se ju efektivisht bënit të njëjtën gjë ose  
15 mendoj që të bënit të njëjtën gjë, a nuk do ishte logjike që  
16 ju të ndanit informacion për t'u siguruar që e kishit gjithë  
17 informacionin e nevojshëm dhe që i gjithë informacioni të  
18 ishte i disponueshëm në një vend, a nuk ishte një pritshmëri  
19 normale kjo?

20 PË. Këto ishin informacionet domethënë të përgjithshme që kam  
21 diskutu jo vetëm me Halil Qadrakun, po kam diskutu edhe me  
22 eprorët e tjerë. Domethënë ku ndodhen pozicionet, çfarë mund  
23 të ndodhë. A mund të sulmojnë a s'mund të sulmojnë, kemi ne  
24 informacion ma të freshtë nga terreni që kanë lëviz forcat  
25 serbe apo çfarë trupash kanë lëviz, e të tjerë, e të tjerë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nezir Çoçaj (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas  
Urdhrit Gojor të 25 nëntor 2024  
Pyetje nga Trupi Gjykses

Page 78

1 këto ish-in në vija të përgjithshme që është dasht me diskutu  
2 me shefin e operativës, me shefin e shtabit. Dhe nëse ma  
3 kërkojnë, domethënë, komandant, zëvendëskomandant, sidomos  
4 komandanti i zonës kanë mujt në çdo kohë me të thirr dhe me të  
5 kërku informacion, ç'ka po ndodh, ku janë, ka lëvizje, s'ka  
6 lëvizje të reja.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po për kundërzbulimin,  
8 pra, për informacionet për të ashtuquajturit bashkëpunëtorë  
9 ose kolaboracionistë? A ishte ky një lloj informacioni për të  
10 cilin ju dhe z. Qadraku flisnit me njëri-tjetrin dhe e  
11 shkëmbenit këtë informacion?

12 PË. Nuk ka pas asnjë rast, as nuk kemi dit që ka ndonjë rast  
13 që dikush është involvu apo ka hy nga sigurime, shërbimet të  
14 tjera. Unë s'kam pas përgatitje të duhur dhe nuk kam biseduar  
15 për një gjë të tillë, domethënë. Ndoshta po të kishte pas, ka  
16 pas mundësi me theksu, me bisedu me mu, po nuk kemi pas rast.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Që të jem i qartë. Si  
18 oficer zbulimi në zonë, juve asnjëherë nuk keni pas në zotërim  
19 informacion që kishte të bënte me bashkëpunëtorët ose  
20 kolaboracionistët në atë zonë. Këtë po thoni, a e kuptova  
21 drejtë?

22 PË. Drejtë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Mund të  
24 kalojmë në seancë publike tani.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të pyes

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nezir Çoçaj (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas  
Urdhrit Gojor të 25 nëntor 2024 Faqe 79  
Pyetje nga Trupi Gjykses

1 se pse po kalojmë nga një temë tek tjetra, cila është baza e  
2 kësaj?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 Z. DIXON: [Përkthim] Ndoshta është më e sigurt se dua ta  
5 kuptoj pak.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitari  
7 mund të dali nga salla.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
10 vazhdoni.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.  
12 Nuk dua t'ju ndërpres ndërkohë që po bëni pyetje, sepse po  
13 qëndrojmë gjatë gjithë kohës në seancë private, por dua të  
14 sqaroj se cila është arsyeja që po kalojmë në seancë private.  
15 Nuk e kuptoj arsyen pse, se mua mu duk se do përmendej një  
16 dëshmitar, por ndërkohë nuk ndodhi kështu. Nuk e di. Ndoshta  
17 do të ishte mirë që të rishikohej kjo pjesa dhe të bëhej  
18 publike.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund t'jua sqaroj unë pse  
20 këtë çështje. Përgjigja është "po". Ideja është që të mbronim  
21 dëshmitarin në fjalë. Megjithatë, në qoftë se nuk dëshiron që  
22 të mbrohet dëshmitari, sikurse e thatë dhe juve, mund të  
23 vendosim që ta bëjmë të hapur edhe këtë pjesë.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Në qoftë se ka ndonjë arsye për masa  
25 mbrojtëse por nuk ka arsye atëherë duhet të rishikohet ky

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nezir Çoçaj (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar sipas  
Urdhrit Gojor të 25 nëntor 2024  
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 80

1 qëndrim dhe duhet të bëhet seancë e hapur dhe kjo pjesa që e  
2 kishim të mbyllur.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Dixon.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le ta sjellim  
5 dhe një herë dëshmitarin në sallë.

6 Të kalojmë në seancë publike në qoftë se nuk jemi ende në  
7 seancë publike.

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 ~~{Seancë e hapur}~~

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar.  
11 Nuk kam pyetje të tjera për ju.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
13 Gaynor.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi  
15 Smith.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
17 jemi në seancë publike.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar. Në  
19 dëshminë që i keni dhënë ZPS-së në janar 2021, në Pjesën 5 --  
20 faqen 5, Pjesa 4, ju pyeteni si më poshtë:

21 "Si pjesë e detyrave tuaja me ZKZ-në ... a keni kryer  
22 intervista me civilë apo ushtarë për të zbuluar informacion që  
23 lidhej me punën tuaj?"

24 Në përgjigje ju keni thënë si më poshtë:

25 "Sigurisht që po. Sigurisht, po."



1 A ju kujtohet ta keni dhënë këtë përgjigje?

2 PË. Jo, nuk e besoj. Intervista me zyrtarë, me civilë dhe të  
3 tjerë, fare nuk kemi pas të bëjmë me ta.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në faqen 13 të Pjesës 4 të  
5 intervistës me ZPS-në, thoni, dhe citoj:

6 "Në qoftë se dikush shoqërohej me serbët, synimi ishte që  
7 të merrte një pasaportë shpejt, domethënë që të merrte  
8 dokumentin shpejt. Sa i takon konstatimit të një  
9 bashkëpunëtori ose kolaboracionisti duhet që informacioni i  
10 zbulimit të ishte i mbështetur. Që të ishte i konstatuar."

11 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

12 PË. Mund ta kem thënë. Konkretisht nuk e di, por mund të jap  
13 edhe sqarime rreth asaj, edhe pavarësisht se s'e kam  
14 deklaratën çfarë kam thënë, po nuk ka qenë bashkëpunëtor i  
15 sigurimit shtetëror dikush që ka ndejt me një polic të  
16 thjeshtë për me e ndihmu me nxjerrë një dokumente, për me pas  
17 një qasje të një dokumenti ma shpejt. Ai s'ka qenë  
18 bashkëpunëtor, po ai ka qëndru me dikënd për një lehtësi  
19 personale të tij. Për me pas një dokument. Kryesisht ne si  
20 shqiptarë të Kosovës asokohe kemi pas mundësinë e mbijetesës  
21 së familjes, financiare edhe të familjes, nëse kemi mund ta  
22 kemi një pasaportë për të shkuar në vendet e perëndimit me  
23 punu me e mbajt familjen. Kjo s'do me thënë se ky ka qenë  
24 bashkëpunëtor i sigurimit shtetëror serb.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Çfarë lloj dëshmie ose çfarë

1 lloj baze ju duhej juve që të shikonit në mënyrë të tillë që  
2 të mbërrinit në përfundimin që dikush ishte bashkëpunëtor?

3 PË. Domethënë, nëse ka pas dokumente, letra rekrutimi,  
4 bashkëpunimi, të drejtpërdrejtë me policinë sekrete serbe.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua t'ju bëj një pyetje që  
6 ju është bërë gjatë intervistës, por përgjigja juaj nuk është  
7 shumë e qartë për mua. E kam fjalën këtu për dallimin midis  
8 zbulimit dhe kundërzbulimit. A mund të na shpjegoni tani se  
9 cili është dallimi ndërmjet të dyve. Domethënë, zbulimi dhe  
10 kundërzbulimi, cili dallimi ndërmjet këtyre dy termave?

11 PË. Domethënë unë nuk jam marrë me këtë punë, mirëpo në  
12 nocionet zbulim dhe kundërzbulim i bjen që involvimi i  
13 forcave, i informatorëve serbë, i forcave ushtarake serbe në  
14 radhës e UÇK-së apo në një mjedis të caktuar. Kjo ka qenë ma  
15 shumë fokusi i kundërzbulimit. Pra, me zbulu, me i zbuluesit  
16 serbë të mundshëm të involvuar në radhët e ushtrisë, për  
17 shembull, gjatë luftës. Unë kështu e kam kuptu.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po për bashkëpunëtorët e  
19 dyshuar ndërmjet popullatës civile shqiptare, po informacionin  
20 lidhur me këtë, ju si e konsideronit, e konsideronit zbulim,  
21 informacion zbulimi apo kundërzbulimi?

22 PË. Ne informacion kundërzbulimi, unë e kam [E pakuptueshme]  
23 unë po të them që kam qenë ju thashë në fillim nuk pas  
24 përgatitje profesionale për t'u marrë me këtë detyrë. Jam  
25 marrë në fakt, jam marrë me detyrë si punë e zorit që duhet ta

1 kryej. Po jo që kam përgatitje profesionale, domethënë. Kjo ka  
2 qenë edhe arsyeja që shumë sende në aspektin profesional as  
3 nuk i kemi kuptuar, as nuk kemi guxuar të mirremi me to.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni marrë ndonjëherë  
5 informacion që sugjeronte që për shembull personat që punonin  
6 në pyje jepnin informacion ose druvarët jepnin informacionin  
7 forcave serbe sa i takon pozicionit të forcave serbe, serbe?  
8 Pozicionit të UÇK-së?

9 PË. Jo, unë s'e kam pas një informacion, s'e kam dëgjuar një  
10 informacion të tillë.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mendonit ju që ekzistonte  
12 rrezikshmëri domethënëse që brenda UÇK-së e kishte -- të  
13 kishte persona që kalonin ose përcillnin informacion për  
14 forcat serbe? A e mendonit këtë si diçka me rrezikshmëri të  
15 konsiderushme?

16 PË. Po, me siguri duhet të kishte rrezikshmëri në dikush i  
17 pason serbëve informacionin lidhur me UÇK-në me pozicionet  
18 tona, po konsideroj që ka qenë informacion jo i duhur dhe ka  
19 qenë të njëjtën kohë ka qenë informacion i rrezikshëm.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po ju, çfarë keni bërë si  
21 oficer që kishit përgjegjësi konkrete të lidhura me shërbimin  
22 e zbulimit dhe kundërzbulimit për ta trajtuar këtë rrezik?

23 PË. Ju thashë nuk kam ndërmarrë asnjë send sepse nuk kam pas  
24 përgatitje dhe nuk jam marrë me këto. Jam marrë ekskluzivisht  
25 me pozicionin e forcave serbe, përshkrimin se ku ndodhen

1 forcat serbe, por nuk jemi marrë me persona me individë dhe  
2 persona të tillë të kësaj kategoria.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A kishte oficerë të tjerë të  
4 ZKZ-së brenda zonës së Pashtrikut që trajtonin rrezikun e  
5 pasjes së bashkëpunëtorëve brenda rangjeve të UÇK-së?

6 PË. Unë e di që ka qenë Xhavit Bajraktari, po as ai nuk ka  
7 pas përgatitje profesionale për trajtimin e një gjëje të  
8 tillë.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Çfarë doni të thoni me këtë?

10 PË. Po dua të them është e vështirë në aspektin profesional  
11 të mirresh me një person që ka instruksione shumë të [E  
12 pakuptueshme] të detaje të përgatitur nga sigurimi shtetëror  
13 serb. Ka pas [E pakuptueshme] përgatitur personalisht nuk  
14 mundesh, sepse nuk sjell asnjë dobi.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera. Ju  
16 falënderoj, Dëshmitar.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.  
18 Prokurore, keni pyetje plotësuese të lidhura me pyetjet e  
19 Gjykatësve?

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam një  
21 pyetje të shkurtër.

22 Pyetje vijuese nga z. Iodice:

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Z. Çoçaj, kur Gjykatësi Barthe ju  
24 bëri pyetje lidhur me këto punktet e kontrollit, ose pikat e  
25 kontrollit në kufirin në Morinë, ju thatë që ishte e pamundur.

1 Dua t'ju pyes, ju personalisht a keni qenë në kufirin e  
2 Morinës, domethënë, ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës me datën  
3 12, 13, 14 qershor 1999? Keni qenë vetë personalisht aty?

4 PË. Nuk e mbaj mend që kam qenë, po të paktën kisha ndëgjuar  
5 nga dikush, kisha mujt ta ndëgjoj nga dikush që ka një punk  
6 apo diçka të tillë.

7 PY. A keni dëgjuar ose a keni folur me ndokënd lidhur me këtë  
8 temë, me këtë çështje? A ju kujtohet?

9 PË. Nuk kam dëgjuar.

10 PY. Faleminderit. Nuk kam pyetje të tjera për ju.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj që të  
13 sqarohet diçka përpara sesa të bëj pyetjet dhe ka të bëjë me  
14 pyetjet që bëri Gjykatësi Mettraux lidhur me Ferhat Shalën.  
15 Pra, ju bëtë disa sugjerime që ai ka thënë disa gjëra të  
16 caktuara, kështu që dua t'ju pyes se cila është baza për këtë.  
17 Keni ndonjë deklaratë përkatëse ose keni ndonjë dokument që  
18 keni parasysh kur e thoni këtë gjë?

19 Dhe jo vetëm kaq, po pastaj dua t'ju kërkoj që të bëjmë  
20 një pushim të shkurtër prej pesë minutash. Nuk do ju kërkoj  
21 shumë kohë për pyetjet, por thjesht sa për t'u organizuar.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jeni me fat sot. Do ju  
23 ndihmoj prapë. Kështu që dokumenti ka numrin ERN 077937, këtë  
24 dokument shikoni -TR-ET dhe ka pjesë të ndryshme, megjithatë  
25 mund t'ju jap ato pjesë të cilat i kam këtu përpara. Për

1 shembull, përfshirë këtu pjesën 1, faqe 21, dhe më pas Pjesa  
2 2, faqja 1 dhe pasuese, Pjesa 9 -- faqja 9 dhe pasuese dhe  
3 faqja 20.

4 Shpresoj që t'ju ndihmojë.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Po, vërtetë që më ndihmoni sepse  
6 doja ta kuptoja më mirë në qoftë se bëhej fjalë për një  
7 deklaratë ku e mbështetët pyetjen tuaj apo jo. Megjithatë,  
8 mesa kuptoj unë aktualisht kjo deklaratë nuk është e pranuar  
9 në prova gjyqësore, por është nxjerrë sipas rregullës 103, si  
10 material shfajësuese. Pra, doja ta sqaroja këtë gjë.

11 Megjithatë, mund t'i referohem, por arsyeja që pse ju pyeta  
12 për materialin se ku e keni bazuar pyetjet tuaja ishte që ta  
13 dija vendin se ku gjendet ky material.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mendoj që sapo e patë, z.  
15 Dixon.

16 Z. DIXON: [Përkthim] E kuptoj, po kjo është baza për  
17 pyetjen. Domethënë është baza një material i cili nuk është i  
18 pranuar në prova gjyqësore. Këtë po thoni, apo jo?

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Sigurisht që do mbaroj brenda  
22 kohës, në mënyrë të tillë që dëshmitari të mbarojë deri në  
23 fund të ditës.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
25 Do bëjmë pushim prej pesë minutash.

1 Dëshmitar, mund të dilni për pesë minuta nga salla.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
4 pushim për pesë minuta.

5 --- Seanca ndërpritet në orën 15.40

6 --- Seanca rifillon në orën 15.50

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni  
8 dëshmitarin.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Përpara se të vijë dëshmitari.  
10 Fillimisht faleminderit për kohën që më dhatë. Unë e kërkoja  
11 këtë kohë në mënyrë që të shihja një urdhër gojor që keni  
12 dhënë ju me 5 qershor 2024 sa i takon njoftimit paraprak që  
13 duhet të bëjnë -- do përdorin Gjykatësit për pyetjet e veta.  
14 Dhe kjo -- është një vendim që e keni marrë në bazë të  
15 rregullës 103. Vetë në urdhrin tuaj, të nderuar Gjykatës, keni  
16 thënë që do na njoftoni paraprakisht ne si ekipe të mbrojtjes  
17 nëse do të përdorni materiale që nuk janë pjesë e provave  
18 gjyqësore. Dhe pikërisht këtë bëri sot Gjykatësi Mettraux. Ne  
19 nuk u njoftuam paraprakisht për materialet që do përdoreshin  
20 sepse këtu nuk keni respektuar vetë urdhrin tuaj. Pra, pyetjet  
21 dhe përgjigjet e Gjykatësit lidhur me këtë nuk duhet të merren  
22 parasysh, nuk duhet t'u jepet peshë, sipas mendimit tonë.

23 Dhe këtë po e them dhe për procesverbal. Nuk mund të  
24 ishte përdorur ky material. Nuk duhej të përdorej ky material,  
25 sepse ju keni nxjerrë një urdhër për këtë. Nëse dëshironi mund

1 t'ju jap një kopje.

2 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,

6 kemi edhe disa pyetje të tjera për ju.

7 Z. Dixon.

8 Pyetje të mëtejshme të palës tjetër nga z.

9 Dixon:

10 Z. DIXON: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, kam shumë pak pyetje. Faleminderit. Pyetja e

12 parë ka lidhje me një pyetje që bëri Gjykatësi Gaynor. Kjo

13 pyetje kishte lidhje me emrin, me z. Bajraktari që ishte pjesë

14 e sektorit të zbulimit të zonës. A ju kujtohet kjo?

15 PË. Po.

16 PY. Dëshiroj ta sqarojmë. A është e vërtetë që z. Bajraktari

17 ka qenë për një periudhë shumë të shkurtër kohore në sektorin

18 e zbulimit? Është bërë pjesë nga fundi i prillit të '99-s dhe

19 më pas është vrarë gjatë konfliktit më 2 maj 1999, kështu?

20 PË. Është e vërtetë.

21 PY. Pra, në këtë periudhë kaq të shkurtër sa ishte ai atje,

22 ju patët ndonjë komunikim me të ose më saktë, e dinit ju se

23 çfarë detyrash kryente ai?

24 PË. Jo, nuk kam dit konkretisht me çfarë detyrash mund të

25 merret ai. E kemi parasysh për një person që nuk ka pas



1 përgatitjen profesionale [E pakuptueshme].

2 PY. Faleminderit. Dëshiroj t'ju bëj disa pyetje për z.

3 Qadraku në kuadër të pyetjeve që ju bëri Gjykatësi Mettraux. A

4 është e vërtetë se keni kaluar kohë të konsiderueshme me z.

5 Qadraku pasi u caktuat në rolin tuaj dhe keni punuar me të

6 qysh prej janarit '99-s, kështu?

7 PË. E vërtetë.

8 PY. Ju nuk ishit në të njëjtën zyrë, por ju shkonit shpesh në

9 zyrën e tij, kështu?

10 PË. [E pakuptueshme] një trup, domethënë me një zyrë kemi

11 punu, po s'ka pas hapësirë të madhe, edhe s'kemi pas punë që

12 kanë të bëjnë aq punë të shumta me ZKZ-në që të merremi

13 drejtpërdrejtë dhe të qëndrojmë në një zyrë me orë të tëna.

14 PY. Po ju keni bisedu me të në zyrën e tij, dhe keni fol për

15 punën që keni bërë sa i takon grumbullimit të informacioneve

16 për pozicionet serbe, kështu?

17 PË. Po.

18 PY. Edhe ai ju jepte ju informacione çfarë kishte grumbulluar

19 ai për shembull për pozicionet, kështu?

20 PY. Zakonisht për pozicione kemi shkëmby sepse i kam shënu, i

21 kam mbajtur evidencë edhe unë edhe ai, domethënë, kur i kemi pas

22 domethënë të përcaktume kush po, nëse unë kam qëndru në zyrë

23 ose unë kam qenë në zyrë informacionet që kanë ardh tek unë i

24 kam marrë i kam shënu i kam plotësu. Pra, i kam evidentu. Të

25 njëjtat gjëna ka mund t'i bën edhe z. Qadraku kur unë s'kam

1 qenë në zyrë.

2 PY. Që të jemi të qartë, kur është ndarë ky informacion ku  
3 përcillej më lartë në strukturën e zonës, keni dijeni? Kujt i  
4 përcillej në strukturën e zonës?

5 PË. Domethënë, personi konkret ka qenë komandanti i zonës. Në  
6 mungesë të komandantit është zëvendëskomandant dhe shefi i  
7 shtabit të zonës. Këta kanë qenë tretë personat kyç. Po primar  
8 i parë, domethënë, ka qenë komandanti i zyrës.

9 PY. A është e vërtetë që ky informacion apo bashkëbisedimi që  
10 bënit ju me të nuk përcillej diku tjetër ose më saktë nuk i  
11 dërgohej drejtpërdrejtë dikujt në Shtabin e Përgjithshëm,  
12 kështu?

13 PË. Unë nuk, nuk mund ta besoj, domethënë, një gjë të tillë  
14 që ka mujt t'i përcillet aq lehtë dikujt tjetër pos zonës.  
15 Domethënë, kulmi i hierarkisë në zonë ka qenë komandanti, atij  
16 i kemi dhënë llogari dhe përgjegjësi. Pastaj vija tjetër nga  
17 zona në Shtab të Përgjithshëm nuk mund të them asnjë send  
18 sepse nuk di as si kanë rrjedhë këto gjëra të tjera.

19 PY. Po. Lidhur me atë që bënte komandant Drini ose më saktë,  
20 se kujt i raportonte ai, ju nuk jeni në pozicion të na thoni  
21 se çfarë procesesh ndiqte, hapash ndiqte ai, kështu?

22 PË. E vërtetë.

23 PY. Por nuk kemi arsye për të besuar se z. Qadraku  
24 anashkalonte komandën e zonës dhe i raportonte vetë ai,  
25 veçmasi, Shtabit të Përgjithshëm, kështu?

1 PË. Nuk ka qenë e mundur pa -- me tejkalu komandantin e  
2 zonës, është dashtë me marrë leje nga komandanti i zonës për  
3 me shku dikun. Është dashtë me marrë arsyetim pse po shkon.  
4 Hierarkia ka qenë komandanti zonës gjegjësit nivelit ma poshtë  
5 tij, zëvendësi dhe shefi i shtabit, jo dikush tjetër.

6 PY. Dhe ju nuk mund të thoni se në praktikë pra, nuk keni  
7 arsye për të besuar se z. Qadraku në praktikë anashkalonte  
8 komandën dhe shkonte drejtpërdrejtë te Shtabi i Përgjithshëm  
9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Është bërë pyetja dhe ka marrë  
10 përgjigje.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet,  
12 mund të përgjigjet dëshmitari.

13 DËSHMITARI: Nuk ka pas arsye, s'është -- s'mund të jap  
14 ndonjë përgjigje konkrete. As s'ka pas arsye, as s'ka mund.

15 Z. DIXON: [Përkthim]

16 PY. Faleminderit. kaq pyetje kisha.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.  
18 Faleminderit Dëshmitarit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje të  
20 tjera për këtë dëshmitar?

21 PËRKTHYESJA: Ekipet e tjera të Mbrojtjes: Nuk kemi  
22 pyetje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
24 tashmë e përfunduat dëshminë tuaj. Nuk keni më detyrime ndaj  
25 këtij Trupi Gjykses. Faleminderit që erdhët dhe ju urojmë

1 rrugë të mbarë.

2 DËSHMITARI: [E padëgjueshme].

3 [Dëshmitari largohet]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshiroj të  
5 pyes Prokurorinë si është plani për nesër.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Bazuar në informacionin që kemi  
7 aktualisht, mendojmë se Dëshmitari W04264 do të jetë -- do të  
8 fillojë dëshminë nesër.

9 Kam edhe diçka tjetër për të trajtuar.

10 Dy provat materiale shoqëruese përkatësisht 01836, 01837,  
11 mund të klasifikohen si publike.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

13 [Përkthim] Në rregull. Do t'i riklasifikojmë si publike.

14 Ka diçka tjetër?

15 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Dua të flasim pak për çështjen e  
16 mosrespektimit të urdhrin gojor.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E dimë, e  
18 dimë. Është zbardhur në procesverbal.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Dixon, lexojeni në  
20 tërësinë e vet urdhrin. Ne kemi thënë "do të përpiqemi" tek  
21 urdhri. E keni lexuar urdhrin?

22 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë e dija që do të  
24 trajtohej kjo temë, megjithatë, z. Dixon, për momentin kur  
25 bëra unë pyetjet, nuk kisha mundësinë tua jepja njoftimin

1 paraparak.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E bëtë një  
3 herë kërkesën, nuk është nevoja të përsëritet.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Gjithashtu, lidhur me pjesën që  
5 trajtuam privatisht. Do të doja të trajtohej menjëherë kjo,  
6 sidomos për z. Qadraku dhe dëshmitarët e tjerë që nuk kanë  
7 kërkuar masa mbrojtëse. Të trajtohet dhe kjo.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 Z. DIXON: [Nuk ka përkthim].

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Mbase është nevoja ta trajtojmë dhe  
12 një herë kur të fillojë ai dëshminë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Dua të them për  
15 procesverbal sa i takon dëshmitarit nesër që nuk na kanë dhënë  
16 arsye pse ka pasur ndryshime në rendin e dëshmitarëve. Por për  
17 ne është e rëndësishme se mbase do ndikojë te kundërpyetjet  
18 tona. Ju lutem të na jepni arsyen pse u ndryshua rendi i  
19 dëshmitarëve, që ta shqyrtojmë edhe ne. Nëse Prokuroria mendoj  
20 që nuk do të ketë asnjë ndikim tek kundërpyetjet tona, atëherë  
21 nuk është nevoja.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
23 njoftojini të gjitha ekipet brenda orës 5.00 të ditës së  
24 sotme.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Është dorëzuar një njoftim

1 zyrtar.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] E pashë njoftimin zyrtar por nuk  
3 ka arsye pse është bërë ndryshimi i dëshmitarëve.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Verifikojeni  
5 ju lutem.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do ta verifikoj dhe një herë. Po  
7 ne aq informacion kishim në dispozicion, vetëm aq informacion  
8 mund të jepnim.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 --- Seanca mbyllet në orën 16.04

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25